

Vendim nr. 45, datë 02.04.2026
(V- 45/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Ilir Toska, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Asim Vokshi, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 02.04.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (L) 2025 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: LUAN MARRA, përfaqësuar nga avokati Sadri Ahmeti, me prokurë të posaçme.

SUBJEKT I INTERESUAR: PROKURORIA E PËRGJITHSHME, përfaqësuar nga prokurori Alfred Progonati, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 74, datë 12.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; nr. 22, datë 31.01.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-2078 (181), datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, paragrafi 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, 28 e vijues të ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (Ligji Organik i Gjykatës).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e kërkuarit Luan Marra (*kërkuar*), i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Përgjithshme, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 29.10.2006 kërkuesi është marrë në pyetje në cilësinë e personit që ka dijeni për veprën penale lidhur me një ngjarje të ndodhur në datën 10.02.2006 në Berat, ku janë gjetur të vrarë me armë zjarri vëllai i kërkuesit, bashkëshortja e tij shtatzënë dhe djali i tyre dyvjeçar. Gjatë pyetjes kërkuesi ka deklaruar se është autor i ngjarjes. Në atë moment janë ndërprerë deklaramet dhe është ftuar të mbrohet me avokat, referuar nenit 37 të Kodit të Procedurës Penale (KPP). Prokurori ka caktuar mbrojtësin Q.B., i cili është njoftuar për pyetjen e personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetime.

2. Një ditë më pas, në datën 30.10.2006, kërkuesi është marrë në pyetje nga oficeri i Policisë Gjyqësore në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime. Referuar procesverbalit të pyetjes të kësaj date, kërkuesi e ka pranuar autorësinë e veprës dhe ka deklaruar në mënyrë të hollësishme dinamikën e ngjarjes. Ai ka deklaruar se ditën e ngjarjes ka shkuar te banesa e viktimave dhe ka debatuar me vëllain për shkak të dyshimeve të këtij të fundit për një marrëdhënie intime midis bashkëshortes së tij dhe kërkuesit, gjë e cila e ka nervozuar kërkuesin dhe pasi është kthyer në shtëpi, ku ka qëndruar pak kohë, ka dalë përsëri, ka marrë një armë automatike në një kotec afër shtëpisë së vëllait të tij, ka hyrë në banesë, dera e së cilës ka qenë e hapur, ka shtyrë derën e kuzhinës me këmbë dhe ka qëlluar fillimisht në drejtim të vëllait të tij, dhe më pas ka kryer qitje me breshëri. Në vijim, kërkuesi ka deklaruar se armën e ka hedhur në lumë dhe se ndihej i penduar për atë që kishte bërë. Procesverbali është firmosur nga kërkuesi, avokati i tij Q.B. dhe oficeri i Policisë Gjyqësore. Po në datën 30.10.2006 është kryer një eksperiment, i fiksuar me video dhe foto, ku kërkuesi ka treguar hollësisht të gjithë mekanizmin e kryerjes së veprës penale. Në po atë datë është bërë dhe ndalimi i kërkuesit. Me vendimin nr. 49, datë 02.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është vleftësuar ndalimi dhe është caktuar masa e sigurimit personal “Arrestimi me burg” ndaj kërkuesit.

3. Një ditë më pas, në datën 31.10.2006, kërkuesi është pyetur në cilësinë e personit të ndaluar nga prokurori në praninë e avokatit të tij. Referuar procesverbalit të pyetjes të asaj dite, kërkuesi ka mohuar autorësinë e vrasjes, duke pretenduar se ka pohuar fajësinë nën presionin e policisë dhe se ka thënë: “Shkruaj çfarë të duash se do ta firmos”, se ka qenë i papërgjegjshëm, i tronditur dhe se e ka improvizuar ngjarjen. Pyetjes së prokurorit se çfarë ka improvizuar, kërkuesi i është përgjigjur duke riprodhuar në mënyrë të detajuar gjithçka kishte deklaruar një ditë më parë.

4. Gjatë hetimit paraprak për këtë çështje janë kryer disa veprime procedurale, si: i) këqyrja e vendit të ngjarjes, nga ka rezultuar se në banesën e viktimave nuk janë konstatuar

shenja dhune, thyerje ose dëmtime të tjera të banesës; ii) akti i ekspertimit balistik nr. 780, datë 16.02.2006 i Institutit të Policisë Shkencore, Tiranë për gëzhojat e sekuestruara; iii) akti i ekspertimit mjeko-ligjor i datës 10.02.2006, ku rezultojnë plagët e viktimave të shkaktuara me armë zjarri, shkak dhe harku kohor i vdekjes; iv) akti i ekspertimit traseologjik nr. 21, datë 12.02.2006, nga ku rezulton se gjurma traseologjike nuk ka vlerë identifikimi, por me anë të saj mundet të arrihet vetëm një përcaktim grupor (numri i këpucës dhe gjatësia e mundshme e autorit); v) akti i ekspertimit traseologjik nr. 41, datë 26.02.2006 për krahasimin e këpucëve të sekuestruara në banesën familjare të kërkuesit me gjurmën e gjetur në vendngjarje, sipas të cilit gjurmët nuk përputhen; vi) akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 269, datë 31.10.2006 për gjendjen shëndetësore të kërkuesit, nga ku ka rezultuar se tek ai janë konstatuar dëmtime në kategorinë e dëmtimeve të parëndësishme për jetën, të shkaktuara në harkun kohor të 24 orëve nga momenti i vizitës; vii) dëshmitë e dëshmitarëve lidhur, më së shumti, me dyshimet për ekzistencën e një marrëdhënieje intime mes kërkuesit dhe viktimës F.M., si dhe alibinë e kërkuesit. Arma e zjarrit nga e cila janë qitur plumbat që kanë shkaktuar vdekjen e viktimave nuk është gjetur në vendin e ngjarjes ose përreth dhe as më vonë gjatë kontrolleve të ushtruara.

Gjykimi i parë

5. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me vendimin nr. 107, datë 23.05.2008, ka vendosur deklarinimin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278/2 të Kodit Penal (KP), dhe e ka dënuar atë përfundimisht me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 117, datë 03.03.2009, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2010-985 (760), datë 24.06.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

6. Në vijim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual. Gjykata, me vendimin nr. 14, datë 03.05.2011 (*vendimi nr. 14/2011 i Gjykatës*) ka vendosur shfuqizimin e vendimeve gjyqësore dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Gjykata ka gjetur shkelje kushtetuese në lidhje me mënyrën e marrjes së dy provave, konkretisht: i) të procesverbalit të marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 30.10.2006; ii) të eksperimentit hetimor të zhvilluar po në datën 30.10.2006. Si shkaqe të këtyre shkeljeve janë evidentuar dhënia e deklaratave ku kërkuesi inkriminon veten pa praninë e mbrojtësit, si dhe dyshimet për rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij, për të cilat autoritetet shtetërore duhet të kishin kryer një hetim më të plotë.

7. Konkretisht, për pretendimin për cenimin e së drejtës së mbrojtjes Gjykata ka çmuar se mbrojtësi ligjor duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit, mbi të gjitha

për të garantuar parandalimin e çdo lloj sjelljeje që mund të lërë shteg për dyshime lidhur me vullnetin e personit të marrë në pyetje. Në këtë kuptim, ajo ka vlerësuar se nuk është e mjaftueshme që mbrojtësi të verifikojë në një moment të mëvonshëm deklaratat e personit të ndaluar, duke arritur në përfundimin se në këtë rast është cenuar neni 31 i Kushtetutës.

8. Lidhur me pretendimin për cenimin e neneve 25 dhe 32 të Kushtetutës, me argumentin se provat në ngarkim të kërkuesit janë marrë nëpërmjet ushtrimit të dhunës, Gjykata ka vërejtur se, ndonëse të ndodhura para pretendimeve dhe dyshimeve serioze faktike për ligjshmërinë e marrjes në pyetje të kërkuesit, gjykatat e zakonshme nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar rrethanat e çështjes. Për këtë, Gjykata ka ritheksuar se deklaratimet e bëra para prokurorit ose Policisë Gjyqësore nuk përbëjnë provë në vetvete, por mund të vlerësohen si të tilla nëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre. Lidhur me eksperimentin e kryer nga policia, menjëherë pasi kërkuesi ka inkriminuar veten, pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, Gjykata ka çmuar se jo vetëm krijohen dyshime serioze për ligjshmërinë e tij, por ai vjen në kundërshtim edhe me standardin kushtetues për mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave.

Gjykimi i dytë

9. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në rigjykim, me vendimin nr. 123, datë 02.03.2012, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për veprat penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278/2 të KP-së, duke e dënuar përfundimisht atë me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 328, datë 27.06.2012, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1593, datë 06.11.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

10. Kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me pretendimin se vendimet gjyqësore të kundërshtuara ishin në kundërshtim me vendimin nr. 14/2011 të saj. Gjykata, me vendimin nr. 20, datë 04.04.2016, e ka vlerësuar pretendimin e kërkuesit të bazuar (*vendimi nr. 20/2016 i Gjykatës*). Gjykata ka evidentuar se në arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë procesverbali i marrjes në pyetje të kërkuesit pa praninë e avokatit (datë 30.10.2006) nuk është pranuar si provë, por se ky procesverbal është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit, pra për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës. Këto deklarime, sipas Gjykatës, nuk mund të përdoren as për efekt kundërshtimi ose besueshmërie, pasi nuk janë marrë në përputhje me ligjin dhe si të tilla janë të pavlefshme. Ndërsa në lidhje me eksperimentin hetimor (po në datën 30.10.2006) dhe aktet e prodhuara prej tij, Gjykata ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar ato të vlefshme, çka, sipas saj, është kërkuar edhe nga mbrojtësi i kërkuesit. Në lidhje me këtë argument, Gjykata ka vërejtur se

mbrojtësi i kërkuesit e ka kërkuar administrimin e kësaj prove me qëllim për të provuar dhunën dhe kërcënimin nga Policia Gjyqësore, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë e ka administruar për të provuar fajësinë e kërkuesit si provë kryesore, pavarësisht se kjo Gjykatë ka konkluduar për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së saj. Për rrjedhojë, Gjykata ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka cenuar procesin e rregullt ligjor dhe këto shkelje nuk janë korrigjuar nga gjykata e apelit dhe as nga Gjykata e Lartë.

Gjykimi i tretë (objekt i ankimit kushtetues individual)

11. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, në gjykimin për herë të tretë të çështjes, me vendimin nr. 74, datë 12.03.2018, ka vendosur deklarinin fajtor të kërkuesit për kryerjen e veprave penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe prodhimit e mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278/2 të KP-së, duke e dënuar atë përfundimisht me burgim të përjetshëm.

12. Lidhur me kërkesat paraprake për pavlefshmërinë e akteve dhe papërdorshmërinë e provave, me vendimin e ndërmjetëm të marrë në seancën e datës 20.07.2016, gjykata e rrethit gjyqësor ka vendosur të deklarojë të papërdorshme provat e siguruara nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006, për shkak se ato (procesverbali i transkriptimit të veprimit hetimor, eksperimenti hetimor për verifikimin e thënieve të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, pamjet filmike dhe fotografike të fiksimit të kësaj prove) janë siguruar në shkelje të ligjit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime (*shih faqet 6-10 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

13. Lidhur me procesverbalin e pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime të datës 30.10.2006, përpara oficerit të Policisë Gjyqësore S.B., ajo gjykatë ka vlerësuar se prokuroria nuk ka kërkuar të merrej si provë në atë moment procedural, ndaj kërkesa e mbrojtjes për deklarinin e pavlefshmërisë së tij ishte pa objekt në momentin e paraqitjes në fazën e kërkesave paraprake, referuar nenit 354 të KPP-së. Më pas, gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokuroria ka kërkuar të bëjë kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit gjatë gjykimit me deklarinimet e bëra nga ai gjatë hetimit dhe gjykata ka vlerësuar se procesverbali duhej pranuar dhe përdorur për këtë qëllim, pasi ka hetuar dhe më pas ka vlerësuar se ai procesverbal është bërë në prani të mbrojtësit të kërkuesit dhe është nënshkruar me vullnet të plotë prej tyre. Këto fakte kanë rezultuar në kuadër të rigjykit nga përmbajtja e procesverbalit, nga nënshkrimi i tij, nga dëshmia e oficerit që ka marrë deklarinimet dhe nga dëshmia e shtetasit Q.B. që ka qenë avokat i kërkuesit gjatë marrjes së këtyre deklarimeve. Ajo gjykatë ka arsyetuar se këto lloj pretendimesh janë të tilla që çdo i pandehur do t'i bënte kur gjendet përballë rrezikut për t'u dënuar me burg përjetë, por në rastin konkret ato nuk mbështeten në provat e administruara në dosje dhe në provat e marra në rigjykim me këtë qëllim, me kërkesë të prokurorisë edhe të

mbrojtjes së kërkuesit. Në kushtet kur ky pretendim nuk rezultoi i mbështetur në prova në vlerësimin e asaj gjykate, procesverballi i marrjes në pyetje i datës 30.10.2006 është i përdorshëm, sipas saj, në kuadër të kundërshtimit të deklarimeve të të pandehurit në gjykim, në referim të nenit 370 të KPP-së, pas pyetjes së kërkuesit të pandehur që pranoi të jepte shpjegime (*shih faqet 10-19 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

14. Lidhur me detyrën e lënë nga kjo Gjykatë për të hetuar pretendimet për dhunimin e kërkuesit para dhe gjatë deklarimeve të tij që tregojnë vetëpërgjegjësi, me pasojë deformimin e vullnetit të tij gjatë këtyre deklarimeve, ajo gjykatë ka vlerësuar se nga provat e sjella nga të dyja palët të administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra-tjetrën, nuk rezulton që deklaratimet e kërkuesit, të datës 30.10.2006, ora 08:00, të jenë marrë në kushtet e deformimit të vullnetit për shkak të dhunës së ushtruar nga punonjësit e policisë dhe, për pasojë, ka lejuar përdorimin në kuadër të kundërshtimit të deklarimeve të të pandehurit në gjykim. Ndër provat e administruara për këtë qëllim janë: i) vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal të datës 31.07.2009, të filluar mbi pretendimet e familjarëve të kërkuesit për ushtrim dhune, ku konkludohet se nuk janë provuar pretendimet e kallëzuesve, vendim i cili nuk është kundërshtuar në gjykatë dhe rezulton se është paraqitur si pretendim pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë; ii) kopje të ankesave të familjarëve drejtuar Avokatit të Popullit, nga ku ka rezultuar se ankimet e familjarëve për dhunimin e kërkuesit gjatë hetimit nga policia janë bërë vetëm pasi ai është dënuar në gjykatën e shkallës së parë; iii) akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 269, datë 31.10.2006, nga i cili ka rezultuar se dëmtimet e konstatuara janë shkaktuar në harkun kohor të 24 orëve nga momenti i vizitës (ora 15:30), ndërsa marrja në pyetje është kryer përpara këtij harku kohor.

15. Për zgjidhjen e çështjes konkrete, gjykata e shkallës së parë ka lejuar marrjen e provave shkresore të ndodhura në fashikullin e gjykimit, provave me dëshmitarë të kërkuara nga të dyja palët, pyetjen e kërkuesit, si dhe një sërë provash shkresore të kërkuara nga mbrojtja e kërkuesit, konkretisht: i) procesverbalet e këqyrjes së kufomave dhe aktet e ekspertimit mjeko-ligjor të datës 10.02.2006; ii) këqyrjen e vendit të ngjarjes; iii) krahasimin e gjurmës traseologjike dhe këpucëve të sekuestruara në banesën familjare të kërkuesit; iv) këqyrjen e viktimave; v) përgjimet ambientale të shtetasve I.M. dhe bashkëshortes së tij M.M., gjini e afërt me kërkuesin dhe viktimën Sh.M.; vi) pyetjen e këtyre të fundit në cilësinë e dëshmitarit; v) dëshmitarët, njëherazi familjarë të kërkuesit, përgjimet e komunikimeve të tyre, dëshminë e babait të viktimës F.M., si dhe deklaratimet e kërkuesit para gjykatës; vii) dëshminë e dëshmitarit V.N., i cili ka qenë në cilësinë e ekspertit kriminalist në vendngjarje; viii) dëshminë e dëshmitarit E.H., i cili ka qenë punonjës i Komisarariatit të Policisë Kuçovë dhe ka marrë pjesë

në eksperimentin hetimor të kryer në datën 30.02.2006; ix) dëshminë e S.B., i cili ka qenë oficeri i Policisë Gjyqësore që ka kryer veprimet hetimore të çështjes.

16. Në lidhje me dëshmitë e punonjësve të policisë që kanë marrë pjesë në kryerjen e akteve procedurale në kuadër të hetimit të çështjes, ajo gjykatë ka arsyetuar se pavarësisht se ato nuk përbejnë prova të drejtpërdrejta për ngjarjen dhe fajësinë, përbëjnë indicie të dobishme, që në unitet me njëra-tjetrën dhe me provat e tjera shkencore dhe me dëshmitarë të administruara në gjykim, përputhen plotësisht me mekanizmin e ngjarjes që rezulton nga këqyrja e vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomave të viktimave, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, akti i ekspertimit teknik të gëzhgojave, procesverbali i marrjes së gjurmës traseologjike, si dhe me vetë mekanizmin e ngjarjes së deklaruar nga kërkuesi në procesverbalin e datës 31.10.2006 (të cilat përputhen plotësisht me deklaratimet në procesverbalin e datës 30.10.2006, i pretenduar si i marrë nën ndikimin e dhunës).

17. Ajo gjykatë ka vlerësuar se edhe po të merret tërësisht i shkëputur procesverbali i datës 31.10.2006, për të cilin nuk ka pasur pretendime për mënyrën e marrjes së tij, kërkuesi ka deklaruar fakte kaq të detajuara dhe të përputhura plotësisht me dinamikën e ngjarjes sa që nuk ka asnjë mundësi objektive që ai t'i mësonte dhe t'i riprodhonte me hollësi nga prokurori, ndërkohë që ka rezultuar e provuar se nuk ka qenë në vendngjarje kur është konstatuar ngjarja, pasi nuk është lejuar, dhe as nuk rezulton që të ketë parë gjatë hetimit veprimet procedurale që kanë qenë duke u kryer, çka nuk përputhet me pretendimin e tij se deklaratimin një ditë më parë e ka shkruar tërësisht oficeri i Policisë Gjyqësore, të cilit kërkuesi pretendon se i ka thënë: "Shkruaj çfarë të duash dhe do ta firmos". Ajo gjykatë ka arsyetuar se paralelisht janë hetuar edhe dy pista të tjera, bazuar edhe në pretendimet e kërkuesit. Në përfundim, ajo gjykatë ka çmuar se nga tërësia e fakteve të provuara me provat e administruara në gjykim, provat shkresore, ato me dëshmitarë, deklaratimet e të pandehurit, indiciet që burojnë nga dëshmitë e punonjësve të policisë, kundërshtimet e dëshmitarëve të dëshmitarëve, leximet e lejueshme për dëshmitarët që ndodheshin jashtë shtetit, kundërshtimet e deklaratimeve të kërkuesit, provohet përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ndodhja e veprës penale dhe autorësia e kërkuesit.

18. Vendimi i mësipërm është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 22, datë 31.01.2020. Ajo gjykatë ka arsyetuar se nga tërësia e akteve të administruara gjatë rigjyimit, veprat penale në ngarkim të kërkuesit i pranon të provuara në të njëjtat rrethana fakti të pranuar edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Ajo gjykatë, sipas saj, ka analizuar dhe vlerësuar drejt aktet e ndodhura në fashikullin për gjykim të paraqitur nga prokurori, deklaratimet e dëshmitarëve të bëra në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim, si dhe pohimet e të pandehurit të bëra në fazën e hetimeve paraprake, të cilat janë trajtuar duke respektuar kërkesat e neneve 149 e 152 të KPP-së dhe janë çmuar pas shqyrtimit në tërësi të

tyre. Gjykata e apelit ka çmuar se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar drejt në raport me njëra-tjetrën këto prova dhe se është provuar plotësisht se autor i këtyre veprave penale është kërkuesi. Gjykata e apelit ka evidentuar në mënyrë të hollësishme provat e administruara në gjykim, me qëllim analizimin e tyre (*shih faqet 80-93 të vendimit të gjykatës së apelit*).

19. Në lidhje me pretendimin për pavlefshmërinë e procesverbalit të datës 30.10.2006, gjykata e apelit ka vlerësuar se me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ai procesverbal nuk mund të deklarohej i pavlefshëm, pasi me vendim të ndërmjetëm të asaj gjykate nuk është lejuar si provë në gjykim, madje as nuk është kërkuar si e tillë nga prokurori. Në këtë drejtim, ajo ka evidentuar se pas marrjes së dëshmisë së avokatit në atë kohë të kërkuesit gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se rezulton prezenca e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje të tij si person ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 30.10.2006, duke theksuar faktin se pyetja ka filluar si person që ka dijeni për veprën penale (datë 29.10.2006), ku prania e mbrojtësit nuk është e detyrueshme, dhe më pas është ndërprerë e ka vijuar si person ndaj të cilit zhvillohen hetime deri në përfundim të pyetjes. Ndërsa lidhur me kërkesën për pavlefshmërinë e eksperimentit hetimor, ajo gjykatë ka evidentuar se gjykata e shkallës së parë, me vendim të ndërmjetëm, ka vendosur të deklarojë të papërdorshme provat e siguruara nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006.

20. Më tej, gjykata e apelit ka vlerësuar se rigjykimi është bërë në përmbushje të detyrave të lëna nga kjo Gjykatë. Fillimisht, ajo ka evidentuar se kësaj Gjykate nuk i është bërë me dije se në atë kohë ka filluar një procedim penal për pretendimet për ushtrim dhune nga organi procedues, i cili është pushuar më pas me vendim të prokurorisë. Në mbështetje të arsytimit të gjykatës së shkallës së parë, ajo ka evidentuar se pretendimi i kërkuesit për marrjen e deklarimeve në ndikimin e dhunës nuk përkon me konkluzionet e aktit të ekspertimit mjekoligjor nr. 269, datë 31.10.2006, pasi koha e marrjes në pyetje në datën 30.10.2006 është para harkut kohor në të cilin mjeku konkludon se janë shkaktuar dëmtimet e konstatuara në trupin e kërkuesit. Për më tepër, sipas gjykatës së apelit, gjatë rigjykimit janë administruar kopje të ankesave të familjarëve të kërkuesit drejtuar Avokatit të Popullit, të cilat kanë rezultuar se janë dërguar pasi kërkuesi është dënuar nga gjykata e shkallës së parë (*shih faqet 93-95 të vendimit të gjykatës së apelit*).

21. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen penale të kërkuesit dhe me vendimin nr. 00-2024-2078 (181), datë 11.07.2024 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Ajo gjykatë ka vlerësuar se pretendimet në lidhje me moszbatimin e vendimeve të kësaj Gjykate nuk qëndrojnë, pasi vendimet e gjykatave të faktit në rigjykim nuk mbështeten në dy provat e kundërshtuara në vendimin e kësaj Gjykate, por në provat e tjera të marra e të verifikuara gjatë shqyrtimit

gjqësor, të cilat janë analizuar në tërësinë e tyre dhe në bazë të bindjes së brendshme që kanë krijuar gjykatat, kanë arritur në konkluzionin se provohet plotësisht dhe tej çdo dyshimi të arsyeshëm autorësia e kërkuesit lidhur me faktin për të cilin akuzohet, duke zbardhur të gjitha elementet e veprës penale. Sipas saj, gjykata e shkallës së parë, me vendim të ndërmjetëm, nuk e ka lejuar marrjen si provë të procesverbalit të datës 30.10.2006, madje as nuk është kërkuar të lejohet si provë nga prokurori në kuadër të kërkesave për prova. Po kështu, Gjykata e Lartë ka evidentuar se gjykata e shkallës së parë ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruar nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006, për shkak se ato (procesverbali i transkriptimit të veprimit hetimor, eksperimenti hetimor për verifikimin e thënieve të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, pamjet filmike dhe fotografike të fiksimit të kësaj prove në datën 30.10.2006) janë siguruar në shkelje të ligjit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, fakt i verifikuar nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 20.07.2016.

22. Në vlerësimin e asaj gjykate, gjykatat e faktit kanë kryer një hetim të plotë dhe të pavarur në rigjykim, si dhe kanë zbatuar detyrat e lëna nga kjo Gjykatë, që kanë të bëjnë me sqarimin e prejardhjes së dëmtimeve të konstatuara tek i pandehuri. Ndërkohë që deklaratimet e bëra nga kërkuesi në cilësinë e personit nën hetim në datën 31.10.2006, në praninë e mbrojtësit, janë vlerësuar nga gjykatat në harmoni me provat e tjera të marra në gjykim, duke vënë në dukje përshkrimet e detajuara të vendit të ngjarjes, pozicionet e viktimave, si dhe përshkrimin e saktë të mekanizmit të ngjarjes, edhe pse nuk ka qenë i pranishëm në vendngjarje dhe as nuk ka pasur akses në veprimet ose aktet hetimore. Sipas vlerësimit të asaj gjykate, vendimmarrjen për deklarinimin fajtor të kërkuesit gjykatat nuk e kanë bazuar në një provë të vetme, e aq më pak te procesverbali i datës 30.10.2006, por në prova dhe indicie të rëndësishme, të sakta e të përputhura me njëra-tjetrën, të cilat në unitet me provat e tjera shkencore, deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake dhe në gjykim nga dëshmitarët, ndërtojnë plotësisht mekanizmin e ngjarjes, ashtu siç rezulton nga këqyrja e vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomave të viktimave etj. Ajo gjykatë ka arritur në përfundimin se në këtë rigjykim nuk ka cenim të procesit të rregullt e të drejtë ligjor dhe se fajësia e kërkuesit nuk bazohet në një provë të vetme, duke referuar edhe në nenin 152/2 të KPP-së, sipas të cilit ekzistenca e një fakti mund të nxirret edhe nga indiciet, kur ato janë të rëndësishme, të sakta dhe në përputhje me njëra-tjetrën. Argumentimi i vendimmarrjes së atyre gjykatave përmbush standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, ku konkluzioni i arritur është logjik, ligjor dhe në përputhje me standardin “përtej çdo dyshimi të arsyeshëm”.

23. Kërkuesi në datën 17.04.2025 i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual, sipas objektit, i cili, pas plotësimit sipas kërkesave ligjore, është regjistruar në datën

19.05.2025. Kolegji i Gjykatës në datën 25.07.2025 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

24. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor në drejtim të:

24.1. *Së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi bazën e provave të mbledhura në mënyrë të paligjshme*, të garantuar nga neni 32, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi vendimet e gjykatave të zakonshme janë bazuar në prova të marra në mënyrë të paligjshme. Për herë të tretë “prova e vetme” e përdorur për të dënuar kërkuesin është procesverbali i pyetjes i datës 30.10.2006.

24.2. *Parimit të paanshmërisë në gjykim*, pasi nga arsyetimi i vendimit të gjykatës së shkallës së parë që ka caktuar masën e sigurimit personal “Arresti me burg” ndaj kërkuesit (nr. 49, datë 02.11.2006 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat), vërehet se për caktimin e kësaj mase gjykata, në thelb, ka vënë provat e datës 30.10.2006, për të cilat kjo Gjykatë ka arritur në përfundimin se janë absolutisht të pavlefshme. Pavarësisht kësaj, ajo gjykatë ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit për revokimin e masës së sigurimit. Gjithashtu, arsyetimi i paligjshëm i asaj gjykate në vendimin e ndërmjetëm të datës 20.05.2016 për “rrezimin e kërkesës për pavlefshmërinë absolute të procesverbalit të marrjes në pyetje të kërkuesit”, dhe se “gjykata do të shprehet në lidhje me pavlefshmërinë absolute të eksperimentit hetimor në një fazë tjetër të gjykimit”, pa e konstatuar më pas si të tillë, tregon njëanshmëri të theksuar të gjykatës në favor të akuzës përpara hapjes së shqyrtimit gjyqësor të çështjes, me qëllim hapjen rrugë të organik procedues për ta riparqitur sërish në rigjykim aktin e pavlefshëm.

24.3. *Parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi nuk provohet kryerja e veprës nga kërkuesi tej çdo dyshimi të arsyeshëm dhe se dyshimet gjykatat i kanë çmuar në favor të akuzës dhe jo të pandehurit. Gjykatat janë mbështetur në prova të marra në mënyrë të paligjshme dhe kanë prezumuar fajësinë e tij. Kërkuesi është deklaruar fajtor duke i dhënë vlerë të paracaktuar një prove, për më tepër absolutisht të pavlefshme, ose duke u bazuar në indicie që nuk janë të sakta dhe që nuk përputhen me njëra-tjetrën. Për më tepër, personi nuk mund të deklarohet fajtor mbi bazën e indicieve. Vendimet referojnë përsëritje të dëshmitarëve të njëjtë me dy gjykimet e mëparshme, të cilët kanë mohuar të kenë dijeni për autorësinë e ngjarjes. Duke

evidentuar në rigjykimin e dytë statusin “person i dënuar” dhe jo “i paraburgosur”, gjykatat e zakonshme kanë paragjykuar haptazi fajësinë e kërkuarit. Siç u provua gjatë rigjykimit, prokuroria dhe gjykatat nuk kanë hetuar pista të tjera hetimore mbi autorë të mundshëm, si dhe nuk kanë marrë letërporosi për të kuptuar personalitetin e viktimës në shtetin ku jetonte dhe punonte.

24.4. *Fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës*, pasi kjo Gjykatë në vendimet e mëparshme të saj ka arritur në konkluzionin se deklarimet e bëra nga kërkuari në datën 30.10.2006, pa praninë e avokatit, nuk mund të përdoren për efekt kundërshtimi ose besueshmërie, pasi nuk janë marrë konform ligjit. Në kundërshtim me arsyetimet e këtyre vendimeve, Gjykata e Lartë nuk përmbledh aspak arsye për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta shkencore dhe shkresore.

24.5. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi në mungesë të provave të drejtpërdrejta shkresore dhe shkencore për fajësinë e kërkuarit, dënimi i tij mbështetet në një anarki arsyetimesh dhe shtrembërime faktesh e provash, pamjaftueshmëri argumentimi dhe arsytimi ligjor për fajësinë dhe dënimin e tij. Gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë të gabuar, të shtrembëruar dhe të qëllimshme të fakteve dhe provave të çështjes, e cila gjen mbështetje vetëm në deduksionet e nxjerra nga hipoteza, dyshime dhe thashetheme, me qëllim fajësimin e kërkuarit dhe dënimin e tij pa u mbështetur në asnjë provë me fuqi të plotë provuese. Vendimi i asaj gjykate nuk referon asnjë dispozitë ligjore. Gjykata e Lartë në mënyrë sipërfaqësore shprehet se gjykatat më të ulëta i kanë respektuar detyrat e lëna nga kjo Gjykatë, pa i arsytuar dhe pa i radhitur ato. Në vendimin e saj faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi. Ajo gjykatë nuk i ka marrë në konsideratë argumentet e kërkuarit dhe nuk ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet e tij në rekurs, si p.sh. e vërteta shkencore për orën e saktë të krimit, mospërputhja e gjurmës së këmbës në vendngjarje me këpucët e kërkuarit, pamundësia e të provuarit zyrtarisht të motivit të kryerjes së veprës penale dhe mosgjethja e armës së krimit.

25. *Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme*, ka paraqitur prapësime me shkrim, duke argumentuar se:

25.1. Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* nuk qëndron, pasi në thelb pretendimet e kërkuarit kanë të bëjnë me çmuarjen e provave nga gjykatat e faktit (neni 152 i KPP-së), mbi të cilat është vendosur fajësia e tij, e cila nuk mund të përbëjë çështje për Gjykatën, pasi kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

- 25.2. Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim* është i pabazuar, pasi nga aktet e administruara nuk rezulton asnjë e dhënë ose provë që të provojë se gjykatat janë treguar të njëanshme. Hetimi gjyqësor është zhvilluar rregullisht, provat janë marrë dhe debatuar në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit dhe vendimi përfundimtar është mbështetur në prova të mjaftueshme e në arsyetim logjik.
- 25.3. I pabazuar është edhe pretendimi për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, pasi gjykatat e faktit në përputhje me nenin 152 të KPP-së kanë vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar ose mbivlerësuar asnjë prej provave që janë lejuar e marrë në gjykim. Gjykimi është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm, ku çdo provë është marrë e verifikuar në seancë gjyqësore dhe i është nënshtruar debatit gjyqësor në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Po kështu, gjykatat i kanë mirargumentuar pretendimet në drejtim të çmuarjes së provave në raport me konkluzionet e Gjykatës, duke treguar kujdesin e duhur në analizën e çdo rrethane, fakti ose pretendimi të parashtruar nga mbrojtja, si dhe duke argumentuar përse provat e kundërta nuk qëndrojnë ose nuk përputhen dhe nuk konfirmohen me provat e tjera. Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit në lidhje me prezumimin e pafajësisë, si edhe atij për papërdorshmërinë e provave, duke arsyetuar se gjykatat e faktit e kanë zbatuar drejt ligjin material e procedural dhe se përfundimi i fajësisë së kërkuesit del logjikisht nga provat përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.
- 25.4. Pretendimi për moszbatimin e *vendimeve detyruese të Gjykatës* nuk qëndron, pasi gjykatat e faktit kanë zbatuar me korrektësi detyrat e përcaktuara nga Gjykata, duke korrigjuar shkeljet e mëparshme dhe duke e zhvilluar procesin brenda kornizës së ligjit dhe garancive kushtetuese. Me të drejtë Gjykata e Lartë ka konstatuar se shkaqet e rekursit ishin të njëjta me shkaqet e ankimit dhe se ato kanë marrë përgjigje të plota dhe të arsyetuara në përputhje me vendimmarrjet e Gjykatës. Siç ka çmuar edhe ajo gjykatë, gjykatat e faktit gjatë rigjykimit kanë kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe shterues, duke analizuar veprimet e kryera nga kërkuesi në raport me provat e verifikuara në gjykim. Këto prova janë marrë dhe janë debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit, duke u çmuar në unison me njëra-tjetrën, nga tërësia e të cilave është krijuar bindja e brendshme, e bazuar në prova, se kërkuesi i ka kryer veprat për të cilat është dënuar. Vendimi nuk është mbështetur në provat e

kundërshtuara nga Gjykata, por në një sërë provash të tjera që janë marrë dhe verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor.

25.5. Edhe pretendimi për cenimin e *standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor* është i pabazuar, pasi, ashtu siç arsyeton edhe Gjykata e Lartë, vendimet e gjykatave të faktit përmbajnë një arsyetim të plotë e të detajuar, ku analizohen të gjitha pretendimet e mbrojtjes dhe çdo rrethanë e rëndësishme. Konkluzioni për fajësinë e kërkuesit dhe argumentimi i vendimmarrjes së gjykatave të faktit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsyetuar, ku konkluzioni është logjik, ligjor dhe në përputhje me standardin “tej çdo dyshim i arsyeshëm”. Gjykata e apelit i është përgjigjur në mënyrë shteruese çdo pretendimi të parashtruar nga kërkuesi, pasi i ka verifikuar ato në raport me provat dhe konkluzionet e vendimeve të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

26. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Referuar neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

27. Kërkuesi, si bartës i të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse/i dënuar në procesin gjyqësor penal ndaj të cilit ka ngritur pretendime.

28. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ajo vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar në formë e substancë mjetet e zakonshme të ankimit për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që individi pretendon se i janë cenuar (*shih vendimet nr. 5, datë 17.03.2022; nr. 14, datë 11.03.2022; nr.*

29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese). Në rastin në shqyrtim, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e sistemit gjyqësor të zakonshëm pas kthimit të çështjes për rishqyrtim nga kjo Gjykatë me vendimin nr. 20/2016. Ai i ka ngritur edhe në substancë pretendimet e tij kushtetuese, prandaj nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

29. Lidhur me legjitimitimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i Ligjit Organik të Gjykatës ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Lidhur me llogaritjen e afatit, Gjykata është shprehur se kur kundërshtohen vendimet e Gjykatës së Lartë, ai fillon nga data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose njoftimit elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Në rastin konkret, kërkuesi ka paraqitur për herë të tretë ankim kushtetues individual për kundërshtimin e procesit gjyqësor në të cilin ai është dënua penalisht. Procesi gjyqësor i kundërshtuar ka përfunduar me vendimin e Gjykatës së Lartë që mban datën 11.07.2024, i cili është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 18.12.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në Gjykatë në datën 17.04.2025, pra brenda afatit ligjor 4-mujor.

31. Për sa i takon legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka parashtruar pretendime për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* në aspektet e *së drejtës për të mos u deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme, së drejtës për t’u gjykuar nga një gjykatë e paanshme, parimit të prezumimit të pafajësisë, standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës, si dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor*.

32. Për sa i përket pretendimit për cenimin e *parimit të paanshmërisë në gjykim*, Gjykata vëren se kërkuesi, për të provuar njëanshmërinë e gjykatës në procesin e kundërshtuar, ka sjellë si argument vendimmarrjet e gjykatave lidhur me masën e sigurimit personal të vendosur ndaj tij. Konkretisht, sipas kërkuesit, gjykata e ka rrëzuar kërkesën për revokimin e masës që kërkuesi ka paraqitur pas vendimit nr. 20/2016 të Gjykatës me arsyetimin se gjykata do të shprehet në një fazë tjetër të gjykimit për pavlefshmërinë e akteve, duke pasur si qëllim t’i hapë rrugë organit të akuzës për t’i përdorur ato sërish.

33. Në jurisprudencën kushtetuese është pohuar se parimi i paanshmërisë nënkupton mungesën e paragjyqimeve nga gjyqtarët në lidhje me çështjen e shtruar përpara tyre, pra që ata të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e njëjës prej palëve. Një gjykatë duhet të jetë e paanshme jo vetëm formalisht, por edhe në mënyrë të shprehur. Në këtë kuptim, Gjykata ka theksuar se respektimi i parimit të paanshmërisë duhet të verifikohet duke aplikuar

testin *subjektiv*, që ka të bëjë me verifikimin e bindjes ose interesit personal të një gjyqtari në një çështje të caktuar dhe testin *objektiv*, me të cilin shqyrtohet nëse gjyqtari ka ofruar garanci procedurale të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim të anshmërisë (*shih vendimet nr. 49, datë 16.10.2023; nr. 23, datë 04.11.2008; nr. 7, datë 11.03.2008 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar se mënyra sesi disponon gjykata lidhur me çdo kërkesë të palëve gjatë procesit gjyqësor është objekt kontrolli nga gjykatat më të larta dhe nuk përbën shkak njëanshmërie. Marrja e vendimeve nga gjyqtarët dhe administrimi i gjykimit prej trupit gjykues janë shfaqje të çmuarjes dhe vlerësimit që i njihet gjyqtarit në gjykimin e çështjes, si shprehje e pavarësisë dhe paanësisë së tij (*shih vendimin nr. 3, datë 15.01.2026 të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Në rastin konkret Gjykata vëren se vendimmarrja e gjykatave lidhur me masën e sigurimit nuk është objekt i ankimit kushtetues individual, por kërkuesi e paraqet atë si argument në drejtim të paanshmërisë së gjykatës në shqyrtimin e çështjes së themelit, prandaj Gjykata do të analizojë nëse kjo vendimmarrje procedurale është e aftë të provojë njëanshmërinë e gjykatës në lidhje me procesin e kundërshtuar.

35. Gjykata çmon se kërkuesi nuk ka arritur të provojë sesi rrëzimi i kërkesës për revokimin e masës së sigurimit ka ndikuar në dënimin e kërkuetit, pra të provojë lidhjen e drejtpërdrejtë të bindjes së brendshme ose të interesit personal të gjyqtarit në procesin për revokimin e masës me procesin e themelit, prandaj vendimmarrja e gjykatave lidhur me zbatimin e masës së sigurimit personal ndaj kërkuetit nuk përbën shkak njëanshmërie në gjykimin e themelit të çështjes. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se ky pretendim i kërkuetit është haptazi i pabazuar.

36. Për pretendimin për cenimin e *fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës*, të garantuar nga neni 132 i Kushtetutës, kërkuesi ka argumentuar se gjykatat e zakonshme, edhe gjatë këtij rigjykimi të çështjes, kanë përdorur prova të deklaruara të pavlefshme sipas kësaj Gjykate me dy vendimet e mëparshme të saj të vitit 2011 dhe 2016. Për këtë arsye, sipas tij, është cenuar edhe e drejta për të mos u deklaruar fajtor mbi akte absolutisht të pavlefshme, që garantohet nga neni 32 i Kushtetutës. Nisur nga natyra dhe thelbi i këtyre pretendimeve, por edhe nga fakti se çështja është shqyrtuar edhe më parë nga Gjykata, vlerësohet që këto pretendime të trajtohen në drejtim të respektimit të standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor, të cilat janë pretendime me natyrë kushtetuese. Edhe për pretendimin për cenimin e *parimit të prezumimit të pafajësisë*, të garantuar nga neni 30 i Kushtetutës, Gjykata çmon se ai bën pjesë në juridiksionin kushtetues dhe do ta analizojë në vijim për bazueshmërinë e tij në themel.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me standardin e arsytimit të vendimit gjyqësor

37. Gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kanë zbatuar dy vendimet e mëparshme të Gjykatës, sipas të cilave deklarimet e bëra nga kërkuesi në datën 30.10.2006, pa praninë e avokatit, nuk mund të përdoren për efekt kundërshtimi ose besueshmërie, pasi nuk janë marrë konform ligjit. Ndërsa Gjykata e Lartë në mënyrë sipërfaqësore shprehet se gjykatat më të ulëta i kanë respektuar detyrat e lëna nga kjo Gjykatë, pa i arsytuar dhe pa i radhitur ato. Në vendimin e saj faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi. Ajo gjykatë nuk i ka marrë në konsideratë argumentet e kërkuesit dhe nuk ka analizuar me kujdes të gjitha pretendimet e tij në rekurs. Gjykata e Lartë nuk përmbledh as arsytet për të cilat gjykata i quan të papranueshme provat e kundërta shkencore dhe shkresore.

38. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykatat e faktit kanë zbatuar me korrektesë detyrat e përcaktuara nga Gjykata, duke korrigjuar shkeljet e mëparshme dhe duke zhvilluar procesin brenda kornizës së ligjit dhe garancive kushtetuese. Gjykata e Lartë ka konstatuar se shkaqet e rekursit ishin të njëjta me shkaqet e ankimit dhe se ato kanë marrë përgjigje të plota dhe të arsytuara në përputhje me vendimmarrjet e Gjykatës. Gjykatat e faktit gjatë rigjykimit kanë kryer një hetim gjyqësor të plotë dhe shterues, duke analizuar veprimet e kryera nga kërkuesi në raport me provat e verifikuara në gjykim. Provat janë marrë dhe janë debatuar sipas parimit të kontradiktoritetit, duke u çmuar në unison me njëra-tjetrën, nga tërësia e të cilave është krijuar bindja e brendshme e bazuar në prova se kërkuesi i ka kryer veprat për të cilat është dënuar. Vendimi nuk është mbështetur në provat e kundërshtuara nga Gjykata, por në një sërë provash të tjera që janë marrë dhe verifikuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Vendimet gjyqësore përmbushin standardin kushtetues të arsytimit. Vendimet e gjykatave të faktit përmbajnë një arsytim të plotë e të detajuar, ku analizohen të gjitha pretendimet e mbrojtjes dhe çdo rrethanë e rëndësishme. Konkluzioni për fajësinë e kërkuesit dhe argumentimi i vendimmarrjes së gjykatave të faktit plotëson standardet e një vendimi gjyqësor të arsytuar, ku konkluzioni është logjik dhe ligjor.

39. Neni 132 i Kushtetutës shprehet qartësisht në lidhje me forcën detyruese që vendimet e Gjykatës kanë mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsytuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do

ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 66, datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjithashtu, në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Në tërësinë e tij vendimi duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr.12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

40. Nën dritën e standardeve të mësipërme dhe bazuar në thelbin e pretendimeve të kërkuesit, Gjykata do të verifikojë nëse në rastin në shqyrtim gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë riparuar cenimin e së drejtës kushtetuese të kërkuesit të konstatuar më parë nga Gjykata dhe që përbënte shkakun e kthimit të çështjes për shqyrtim, si dhe nëse vendimet e atyre gjykatave janë të arsytuara, pa gabime ligjore ose faktike të dukshme.

41. Gjykata fillimisht vë në dukje se me vendimin nr. 14/2011 ajo ka shfuqizuar vendimet e gjykatave të zakonshme, pasi ka konstatuar cenimin e së drejtës së mbrojtjes, duke vlerësuar se nuk është e mjaftueshme që mbrojtësi të verifikojë në një moment të mëvonshëm deklaratat e personit të ndaluar, si dhe të së drejtës të mos deklaronim fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme në lidhje mënyrën e marrjes së dy provave: i) procesverbalit të marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 30.10.2006 dhe ii) eksperimentit hetimor të zhvilluar po në datën 30.10.2006. Si shkaqe të këtyre shkeljeve janë evidentuar dhënia e deklaratave ku kërkuesi, sipas Gjykatës, inkriminon veten pa praninë e mbrojtësit, si dhe dyshimet për rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij, për të cilat autoritetet shtetërore duhet të kishin kryer një hetim më të plotë. Ndërsa shkak i shfuqizimit të vendimeve gjyqësore nga Gjykata me vendimin nr. 20/2016 lidhej me faktin se ndonëse gjykata e shkallës së parë nuk e ka pranuar si provë procesverbalin e marrjes në pyetje të kërkuesit pa praninë e avokatit (datë 30.10.2006), ai është përdorur nga prokuroria për të treguar besueshmërinë e të pandehurit, pra për të kundërshtuar deklaratimet e tij përpara gjykatës, dhe sipas saj procesverbali nuk mund të përdorej as në këtë kontekst.

42. Nga arsytimi i vendimeve të kundërshtuara, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë, me vendimin e ndërmjetëm të marrë në seancën e datës 20.07.2016, ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruar nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006, për shkak se ato (procesverbali i transkriptimit e veprimi hetimor, eksperimenti hetimor për verifikimin e thënieve të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, pamjet filmike dhe fotografike të fiksimit të kësaj prove) janë siguruar në shkelje të ligjit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime.

43. Lidhur me procesverbalin e pyetjes së personit ndaj të cilit zhvillohen hetime të datës 30.10.2006, ajo gjykatë ka vlerësuar se ai akt nuk ishte kërkuar të merrej si provë nga ana e prokurorisë në atë moment procedural dhe as nuk është lejuar të merrej si provë me vendimin për lejimin e provave, ndaj kërkesa e mbrojtjes për deklarimin e pavlefshmërisë së tij ishte pa objekt në momentin e paraqitjes së saj në fazën e kërkesave paraprake. Më pas, gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokuroria ka kërkuar të bëjë kundërshtimin e deklarimeve të kërkuarit gjatë gjykimit me deklaratimet e bëra nga ai gjatë hetimit dhe gjykata ka vlerësuar se ai procesverbal duhej pranuar dhe përdorur për këtë qëllim, pasi ka hetuar dhe më pas ka vlerësuar se ai procesverbal është bërë në prani të mbrojtësit të kërkuarit dhe është nënshkruar me vullnet të plotë prej tyre. Këto fakte kanë rezultuar në kuadër të rigjyimit nga përmbajtja e procesverbalit, nga nënshkrimi i tij, nga dëshmia e oficerit që ka marrë deklaratimet dhe nga dëshmia e shtetasit Q.B. që ka qenë avokat i tij gjatë marrjes së këtyre deklarimeve. Ajo gjykatë ka arsyetuar se këto lloj pretendimesh janë të tilla që çdo i pandehur do t'i bënte kur gjendet përballë rrezikut për t'u dënuar me burg përjetë, por në rastin konkret ato nuk mbështeten në provat e administruara në dosje dhe në provat e marra në rigjykim me këtë qëllim, me kërkesë të prokurorisë edhe të mbrojtjes së kërkuarit. Në kushtet kur ky pretendim nuk rezultoi i mbështetur në prova në vlerësimin e asaj gjykate, procesverbali i marrjes në pyetje i datës 30.10.2006 është i përdorshëm sipas saj në kuadër të kundërshtimit të deklarimeve të të pandehurit në gjykim, në referim të nenit 370 të KPP-së, sikur se u kërkuar dhe lejua nga gjykata, pas pyetjes së kërkuarit të pandehur që pranoi të jepte shpjegime (*shih faqet 10-19 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*).

44. Ndërsa lidhur me detyrën e lënë nga Gjykata për të hetuar pretendimet për dhunimin e kërkuarit para dhe gjatë deklarimeve të tij që tregojnë vetëpërgjegjësi, me pasojë deformimin e vullnetit të tij gjatë këtyre deklarimeve, ajo gjykatë ka vlerësuar se nga provat e sjella nga të dyja palët të administruara në gjykim, të analizuara në raport me njëra-tjetrën, nuk rezulton që deklaratimet e kërkuarit të marra në datën 30.10.2006, ora 08:00, të jenë marrë në kushtet e deformimit të vullnetit për shkak të dhunës së ushtruar nga punonjësit e policisë dhe, për pasojë, ka lejuar përdorimin në kuadër të kundërshtimit të deklarimeve të të pandehurit në gjykim, sikurse u kërkuar. Ndër provat e administruara për këtë qëllim janë: i) vendimi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pushimin e procedimit penal të datës 31.07.2009, të filluar mbi pretendimet e familjarëve të kërkuarit për ushtrim dhune, ku konkludohet se nuk janë provuar pretendimet e kallëzuesve, vendim i cili nuk është kundërshtuar në gjykatë dhe rezulton se pretendimi është paraqitur pas përfundimit të gjykimit në shkallë të parë; ii) kopjet e ankesave të familjarëve drejtuar Avokatit të Popullit, nga ku ka rezultuar se ankimet e familjarëve për dhunimin e kërkuarit gjatë hetimit nga policia janë bërë vetëm pasi ai është dënuar në gjykatën

e shkallës së parë; iii) akti i ekspertimit mjeko-ligjor nr. 269, datë 31.10.2006, nga i cili ka rezultuar se dëmtimet e konstatuara janë shkaktuar në harkun kohor të 24 orëve nga momenti i vizitës (ora 15:30), ndërsa marrja në pyetje është kryer përpara këtij harku kohor.

45. Për sa më lart, në lidhje me *eksperimentin hetimor dhe aktet e prodhuara prej tij*, Gjykata evidenton se me vendimin e mëparshëm të saj nr. 14/2011 ka arritur në përfundimin se aktet e prodhuara nga eksperimenti hetimor janë siguruar në shkelje të ligjit. Në të njëjtën linjë, gjykata e shkallës së parë në procesin e kundërshtuar, me vendim të ndërmjetëm, i ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruar nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006, me arsyetimin se ato janë siguruar në shkelje të ligjit, duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, në zbatim të konkluzioneve të mëparshme të kësaj Gjykate për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së tyre. Për rrjedhojë, vendimi i Gjykatës është zbatuar për këtë pjesë.

46. Në lidhje me *procesverbalin e marrjes në pyetje të kërkuarit pa praninë e avokatit*, Gjykata evidenton se me vendimin e saj nr. 20/2016 ka konstatuar se procesverbali i marrjes në pyetje nuk mund të merrej si provë dhe nuk mund të përdorej për të kundërshtuar deklaratimet e kërkuarit përpara gjykatës nga prokuroria, pasi është marrë në kundërshtim me ligjin dhe është i pavlefshëm. Në procesin e kundërshtuar Gjykata vëren se, megjithëse procesverbali në fjalë nuk është marrë si provë, gjykatat e zakonshme kanë lejuar përdorimin e tij për kundërshtimin nga prokuroria të thënieve të kërkuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në këtë përfundim ato gjykata kanë arritur pasi më parë kanë kryer një hetim të plotë në drejtim të pretendimeve të kërkuarit për marrjen e kësaj prove nën ndikimin e dhunës nga policia. Nga ky hetim ka rezultuar se avokati i caktuar kryesisht ka qenë i pranishëm përgjatë gjithë marrjes në pyetje të datës 30.10.2006 dhe se ndaj kërkuarit nuk është ushtruar dhunë nga Policia Gjyqësore ose prokuroria, duke u arritur kështu në përfundimin se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur. Prandaj, Gjykata vlerëson se, pavarësisht se procesverbali i pyetjes së kërkuarit nuk mund të përdorej as në një kontekst të tillë (pra, për të kundërshtuar thëniet e kërkuarit gjatë shqyrtimit gjyqësor), kundërshtimi i mënyrës së marrjes së kësaj prove është lidhur më parë nga Gjykata me cenimin e së drejtës së mbrojtjes së kërkuarit dhe me pretendimin se gjykatat e zakonshme nuk kishin hetuar për pretendimet e tij për marrjen e këtyre deklaratimeve nën ndikimin e dhunës. Në kushtet kur gjatë gjykimit të kundërshtuar gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, pas një hetimi të plotë, kanë arritur në përfundimin se kërkuarit nuk i është cenuar e drejta për t'u mbrojtur, Gjykata vlerëson se, në ndryshim nga sa pretendon kërkuari, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk rezultojnë të mos kenë respektuar forcën detyruese të vendimeve të Gjykatës.

47. Për sa i takon pretendimit të kërkuarit se Gjykata e Lartë nuk i ka arsyetuar dhe renditur detyrat e lëna nga kjo Gjykatë, se faktet dhe rrethanat e çështjes nuk janë pasqyruar me saktësi dhe vërtetësi, se nuk janë marrë në konsideratë argumentet e kërkuarit dhe se ajo gjykatë nuk ka analizuar të gjitha pretendimet e tij në rekurs, Gjykata konstaton se Gjykata e Lartë i ka shqyrtuar në themel shkaqet e rekursit të kërkuarit në seancë gjyqësore publike, ku ka qenë i pranishëm edhe mbrojtësi i tij. Në vendimin e saj ajo gjykatë ka renditur rrethanat e çështjes, të cilat nuk duken të jenë të pasakta ose të pavërteta, duke pasqyruar arsyetimet e vendimeve të gjykatave përgjatë të tria gjykimeve, duke theksuar edhe dy proceset kushtetuese, përfshirë arsyetimin e Gjykatës në të dyja rastet. Po kështu, në vendimin e kundërshtuar Gjykata e Lartë ka pasqyruar shkaqet e ngritura në rekurs nga kërkuari, si dhe ka shqyrtuar në themel pretendimet thelbësore për moszbatimin e vendimeve të detyrueshme të kësaj Gjykate dhe për cenimin e parimit të prezumimit e pafajësisë, për të cilat ka çmuar se nuk qëndrojnë, duke lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit. Nën këtë optikë, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë në vendimet e kundërshtuara përmes ankimit kushtetues individual ka përmbushur detyrimin për arsyetimin e vendimit të saj, i cili nuk rezulton i paarsyeshëm në këndvështrimin kushtetues, duke marrë në shqyrtim, analizuar dhe vlerësuar në mënyrë të argumentuar pretendimet e kërkuarit në rekurs.

48. Në kuptim të sa më sipër, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuarit për cenimin e standardit të zbatimit të detyrueshëm të vendimeve të Gjykatës të lidhur me standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë

49. Kërkuari ka pretenduar se fajësia e tij nuk është provuar tej çdo dyshimi të arsyeshëm, nuk është bazuar në asnjë provë me fuqi të plotë provuese dhe dyshimi ka shkuar në favor të akuzës. Kërkuari është deklaruar fajtor duke i dhënë vlerë të paracaktuar një prove, për më tepër absolutisht të pavlefshme, ose duke u bazuar në indicie që nuk janë të sakta dhe që nuk përputhen me njëra-tjetrën. Gjykata e shkallës së parë ka bërë një analizë të gabuar, të shtrembëruar dhe të qëllimshme të fakteve dhe provave të çështjes, e cila gjen mbështetje vetëm në deduksionet e nxjerra nga hipoteza, dyshime dhe thashetheme. Në vendimet gjyqësore kërkuari ka statusin “person i dënuar” dhe jo “i paraburgosur”, që tregon hapur paragjykimin e gjykatave të zakonshme. Prokuroria dhe gjykatat nuk kanë hetuar pista të tjera hetimore mbi autorë të mundshëm, si dhe nuk kanë marrë letërporosi për të kuptuar personalitetin e viktimës në shtetin ku jetonte dhe punonte.

50. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Përgjithshme, ka prapësuar se gjykatat e faktit kanë vlerësuar dhe analizuar provat në përputhje me nenin 152 të KPP-së, në tërësi dhe në

lidhje me njëra-tjetrën, duke mos i dhënë vlerë të paracaktuar ose mbivlerësuar asnjë prej tyre. Gjykimi është zhvilluar sipas procedurës së gjykimit të zakonshëm, ku çdo provë është marrë dhe verifikuar në seancë gjyqësore, i është nënshtruar debatit gjyqësor në përputhje me parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit. Gjykatat i kanë mirargumentuar pretendimet në drejtim të çmuarjes së provave në raport me konkluzionet e Gjykatës, duke treguar kujdesin e duhur në analizën e çdo rrethane, fakti ose pretendimi të parashtruar nga mbrojtja, si dhe duke argumentuar përse provat e kundërta nuk qëndrojnë, nuk përputhen dhe nuk konfirmohen me provat e tjera. Edhe Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje pretendimit në lidhje me prezumimin e pafajësisë, ashtu edhe atij për papërdorshmërinë e provave, duke arritur në përfundimin se gjykatat e faktit e kanë zbatuar drejt ligjin material dhe procedural dhe se përfundimi i fajësisë së kërkuesit del logjikisht nga provat përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

51. Parimi i prezumimit të pafajësisë parashikohet në nenin 30 të Kushtetutës, sipas të cilit kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim gjyqësor të formës së prerë. Gjykata ka theksuar se parimi i prezumimit të pafajësisë për gjykimin penal kërkon që deklarimi i fajësisë të të pandehurit të bëhet nga gjykata vetëm pas një shqyrtimi të plotë të çështjes. Asnjë masë që barazohet me dënimin nuk mund të jepet ndaj një të pandehuri pa u provuar fajësia e tij përtej çdo dyshimi të arsyeshëm (*shih vendimet nr. 27, datë 29.04.2025; nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 20, datë 03.04.2024 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykatat e zakonshme nuk duhet ta fillojnë procesin me bindjen se i pandehuri ka kryer krimin për të cilin akuzohet. Barra e provës i takon palës akuzuese dhe çdo dyshim duhet të shkojë në favor të të pandehurit. Gjykatat duhet ta mbështesin vendimin në prova të drejtpërdrejta dhe të tërthorta që duhet të provohen nga akuza. Ato janë të detyruara të përcaktojnë faktet e çështjes, të rëndësishme për vlerësimin e përgjegjësisë ligjore të të akuzuarit, sa më qartë dhe saktë të jetë e mundur dhe nuk mund t'i paraqesin ato thjesht si aludime ose dyshime (*shih vendimet nr. 26, datë 29.04.2025; nr. 38, datë 12.07.2023; nr. 10, datë 12.04.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

52. Gjykata gjithashtu ka pohuar se kur vlerësohet parimi i prezumimit të pafajësisë në çështjet penale, prezumimet e faktit ose të ligjit nuk janë të ndaluara, por ato duhet të jenë brenda kufijve të arsyeshëm, duke mbajtur në konsideratë rëndësinë e interesit që rrezikohet dhe të sigurojnë të drejtat e mbrojtjes (*shih vendimet nr. 67, datë 05.11.2025; nr. 63, datë 20.11.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Gjykata ka evidentuar edhe dallimin që ekziston midis mënyrës së marrjes të provave dhe vlerësimit të tyre në procesin gjyqësor. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të përcaktojë rëndësinë vendimtare të një prove, për sa kohë që gjykatat e zakonshme, në arsyetimin e vendimeve të tyre, e mbështesin fajësinë

e kërkuesit edhe mbi disa prova të tjera (*shih vendimet nr. 67, datë 05.11.2025; nr. 40, datë 22.09.2011; nr. 9, datë 28.04.2004 të Gjykatës Kushtetuese*).

53. Nën dritën e këtij standardi, si dhe duke mbajtur në konsideratë pretendimet dhe prapësimet e palëve, Gjykata do të analizojë nëse në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit gjykatat e zakonshme kanë respektuar garancitë procedurale të parimit të prezumimit të pafajësisë, pra nëse ato gjykata kanë provuar fajësinë e tij tej çdo dyshimi të arsyeshëm në drejtim të ndalimit të paragjyimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit në kuptim të: (a) mosdhënies vlerë të paracaktuar provave (b) përdorimit në mënyrë të arsyeshme të prezumimeve të faktit dhe mospërcaktimit të përgjegjësisë ligjore të kërkuesit bazuar në aludime ose dyshime (c) mosdhënies kërkuesit të statusit të “personit të dënuar” (ç) marrjes së provave që e shfajësonin kërkuesin.

54. Në drejtim të *mosdhënies vlerë të paracaktuar provave (a)*, kërkuesi ka parashtruar se gjykatat i kanë dhënë vlerë të paracaktuar një prove, për më tepër të pavlefshme, duke iu referuar procesverbalit të marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 31.10.2006.

55. Në parantezë të analizës së këtij argumenti, Gjykata ka pohuar se kur mënyra e vlerësimit të provave nga gjykatat e zakonshme është vënë në dyshim nga kërkuesi, si shkak për të cilin atij i është cenuar e drejta për t’u prezumuar i pafajshëm, vlerësimi i provave bën pjesë në juridiksionin kushtetues (*shih vendimin nr. 26, datë 29.04.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Për këtë arsye, Gjykata në vijim do të analizojë nëse vlerësimi i provave në procesin penal të zhvilluar ndaj kërkuesit ka zhvendosur barrën e provës nga prokurori te kërkuesi dhe nëse fajësia e këtij të fundit është vendosur përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

56. Sikurse u theksua në rrethanat e çështjes, çështja penale është kthyer për shqyrtim në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për herë të dytë nga kjo Gjykatë. Në lidhje me procesverbalin e marrjes në pyetje të kërkuesit të datës 31.10.2006, nga sa u analizua në mënyrë të detajuar më sipër (*shih paragrafin 43 të vendimit*), ai është përdorur për të kundërshtuar thëniet e kërkuesit gjatë shqyrtimit gjyqësor, pas një hetimi të plotë, dhe në respekt të së drejtës së për t’u mbrojtur të tij. Gjithsesi nuk rezulton se gjykatat e zakonshme e kanë bazuar vendimin e tyre vetëm në këtë provë. Konkretisht, në përfundim të rigjyimit, gjykata e shkallës së parë në lidhje me fajësinë e kërkuesit, në përmbushje edhe të detyrave të lëna nga kjo Gjykatë, ka analizuar provat duke përcaktuar rrethanat faktike të mëposhtme. *Së pari*, për hapjen e derës së banesës së viktimave nuk është ushtruar dhunë dhe kërkuesi është provuar se hynte lirisht në banesë, pasi ishte vëllai i viktimës Sh.M. dhe qëndronte në shtëpinë e tij ndërkohë që viktima ishte në emigrim. Këto të dhëna, sipas gjykatës, janë konfirmuar nga këqyrja e vendit të ngjarjes, nga dëshmitë e dëshmitarëve dhe pohimet e kërkuesit. *Së dyti*, kërkuesi ka pranuar autorësinë e veprës gjatë pyetjes si person që ka dijeni për veprën penale

(datë 29.10.2006). *Së treti*, gjatë pyetjes në cilësinë e personit të ndaluar kërkuesi ka riprodhuar me saktësi çdo detaj që ka pretenduar se ka improvizuar një ditë më parë, që, për më tepër, përputhen plotësisht me mekanizmin e ngjarjes siç rezulton nga të gjitha provat shkresore/shkencore dhe që do t'i kishte të pamundura t'i dinte në kushtet kur është vërtetuar se ai nuk ka qenë i pranishëm kur është konstatuar ngjarja. Këto deklarime kërkuesi i ka bërë në prani të avokatit dhe për to nuk ka pasur pretendime për pavlefshmëri ose papërdorshmëri. Në nxjerrjen e këtyre rrethanave gjykata e shkallës së parë është bazuar: (i) në dëshmitë e dëshmitarëve në vendngjarje kur është konstatuar ngjarja, sipas të cilëve kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm për të parë veprimet hetimore; (ii) në procesverbalin e marrjes në pyetje të datës 29.10.2006, ku kërkuesi ka pranuar autorësinë e veprës; (iii) në procesverbalin e datës 31.10.2006, ku kërkuesi ka riprodhuar me saktësi çdo detaj që ka pretenduar se ka improvizuar një ditë më parë. *Së katërti*, ndaj kërkuesit nuk është ushtruar dhunë për marrjen e deklarimit të datës 30.10.2006, ku ka pranuar autorësinë e veprës penale. Këto të dhëna, sipas gjykatës, janë konfirmuar: (i) nga akti i ekspertimit mjeko-ligjor, sipas të cilit dëmtimet në trupin e kërkuesit janë shkaktuar në një hark kohor të mëvonshëm nga ai i marrjes në pyetje; (ii) nga dëshmia me dëshmitar, sipas së cilës kërkuesi është rrahur nga të paraburgosur të tjerë në ambientet e paraburgimit; (iii) nga ankesat e familjarëve drejtuar Avokatit të Popullit, ku pretendimet për ushtrim dhune datojnë pas vendimit të gjykatës së shkallës së parë që e ka dënuar kërkuesin me burgim të përjetshëm. *Së pesti*, kërkuesi ka pasur motiv për kryerjen e veprës penale. Ky fakt është provuar nga dëshmitë e marra gjatë hetimit dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në rigjykim, si dhe nga pohimet e vet kërkuesit.

57. Çështja e kërkuesit është gjykuar në vijim nga gjykata e apelit, e cila, pasi i ka vlerësuar provat sipas nenit 152 e vijues të KPP-së, ka arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej plotësisht. Ajo gjykatë i ka pranuar të provuara të njëjtat rrethana fakti të pranuar edhe në vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Gjykata e apelit ka shpjeguar në vendimin e saj edhe arsyet përse nuk qëndronin kundërshtimet që kërkuesi ka pasur për përmbajtjen e provave dhe saktësinë e tyre, duke arsyetuar, sikurse u theksua në rrethanat e çështjes, se deklaratimet e dëshmitarëve të bëra në fazën e hetimeve paraprake dhe në gjykim, si dhe pohimet e të pandehurit të bëra në fazën e hetimeve paraprake janë trajtuar sipas përcaktimeve të neneve 149 e 152 të KPP-së, janë çmuar në tërësi të tyre dhe janë vlerësuar drejt në raport me njëra-tjetrën. Pretendimin se disa prova janë mbledhur në mënyrë të paligjshme, nëpërmjet ushtrimit të dhunës, ajo gjykatë e ka gjetur të pabazuar, me arsyetimin se koha e marrjes në pyetje të kërkuesit është para harkut kohor në të cilin i janë shkaktuar dëmtimet trupore sipas aktit të ekspertimit mjeko-ligjor, si dhe se ankesat e familjarëve drejtuar Avokatit të Popullit janë dërguar pasi kërkuesi është dënuar në shkallë të parë. Për sa i takon

pretendimit për pavlefshmërinë e procesverbalit të marrjes në pyetje të datës 30.10.2006, gjykata e apelit ka vlerësuar se ai nuk mund të deklarohet i pavlefshëm, pasi me vendim të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë nuk është lejuar si provë në gjykim. Megjithatë, ajo ka evidentuar se pas marrjes së dëshmisë së avokatit në atë kohë të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se rezulton prezenca e tij gjatë marrjes në pyetje të kërkuesit si person ndaj të cilit zhvillohen hetime në datën 30.10.2006, duke theksuar edhe faktin se pyetja ka filluar si person që ka dijeni për veprën penale (datë 29.10.2006), ku prania e mbrojtësit nuk është e detyrueshme, dhe më pas është ndërprerë dhe ka vijuar si person ndaj të cilit zhvillohen hetime. Lidhur me kërkesën për pavlefshmërinë e eksperimentit hetimor, ajo gjykatë ka evidentuar se me vendim të ndërmjetëm të gjykatës së shkallës së parë janë deklaruar të papërdorshme provat e siguruara nga ai eksperiment.

58. Kërkuesi ka paraqitur rekurs, duke pretenduar, ndër të tjera, cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, të cilin e ka lidhur me mënyrën e vlerësimit të provave, që, sipas tij, vetëm ngrenë dyshime, ndaj ato duhet të ishin vlerësuar në favor të tij dhe jo kundër tij. Gjykata e Lartë ka marrë në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen e kërkuesit dhe në përfundim ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit. Sipas Gjykatës së Lartë, në zbatim të nenit 152 të KPP-së, gjykata e apelit ka vlerësuar dhe analizuar provat në tërësi dhe në lidhje me njëra-tjetrën, duke mos paracaktuar dhe mbivlerësuar asnjë provë, si dhe duke i dhënë përgjigje të argumentuar dhe shteruese pretendimit të kërkuesit. Provat i janë nënshtruar debatit gjyqësor nën parimin e kontradiktoritetit, ku palët kanë pasur mundësinë të diskutojnë rreth fuqisë provuese të secilës prej provave të administruara në gjykim. Në këtë drejtim, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se vendimmarrjen e tyre gjykatat nuk e kanë bazuar në një provë të vetme, atë të deklarimeve vetinkriminuese të tij, marrë në datën 30.10.2006, por në prova dhe indicie të rëndësishme, të sakta e të përputhura me njëra-tjetrën, të cilat në unitet me provat e tjera shkencore, deklaratimet e dhëna gjatë hetimeve paraprake dhe në gjykim nga dëshmitarët, ndërtojnë plotësisht mekanizmin e ngjarjes, ashtu siç rezulton nga këqyrja e vendit të ngjarjes, këqyrja e kufomave të viktimave etj.

59. Po ashtu, Gjykata e Lartë i ka dhënë përgjigje të arsyetuar edhe pretendimeve të kërkuesit lidhur me papërdorshmërinë e provave, duke vlerësuar se ishin të pabazuara në ligj, pasi gjykata e shkallës së parë nuk e ka lejuar marrjen si provë të procesverbalit të datës 30.10.2006 (as nuk është kërkuar të lejohet si provë nga prokurori), si dhe ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruara nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006, për shkak se ato (procesverbali i transkriptimit të veprimit hetimor, eksperimenti hetimor për verifikimin e thënieve të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, pamjet filmike dhe fotografike të fiksimit të kësaj prove në datën 30.10.2006) janë siguruar në shkelje të ligjit, duke cenuar të drejtën e

mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, fakt i verifikuar nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 20.07.2016.

60. Për sa më lart, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë nuk i kanë dhënë vlerë të paracaktuar asnjë prove dhe se ato kanë arritur në përfundimin se kërkuesi ishte autor i veprave penale, duke analizuar për këtë qëllim në vendimet e tyre përmbajtjen e provave të shqyrtuara dhe duke shpjeguar sesi ato lidheshin logjikisht me njëra-tjetrën, pa i dhënë ndonjëherë prej tyre vlerë të paracaktuar.

61. Në drejtim të *mospërcaktimit të përgjegjësisë ligjore të kërkuesit bazuar në aludime ose dyshime (b)* kërkuesi ka pretenduar se provat e shqyrtuara, në veçanti provat me dëshmitarë, kanë ngritur vetëm dyshime dhe ndonëse dyshimet duhet të ishin vlerësuar në favor të kërkuesit, gjykatat e zakonshme i kanë vlerësuar në favor të akuzës, duke dhënë vendim fajësie për kërkuesin.

62. Nisur nga rrethanat e parashtruara në arsyetimet e vendimeve gjyqësore të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të sipërcituara, si dhe në provat në të cilat gjykatat e zakonshme kanë bazuar vendimet e tyre (*shih paragrafët 53-56 të vendimit*), Gjykata vlerëson se ato vendime gjyqësore kanë përcaktuar gjerësisht rrethanat e çështjes dhe janë përpjekur të evidentojnë shkallën e rëndësisë ose peshës që luan secila, të analizuar në kompleksin e përgjithshëm të tyre, kanë arsyetuar mjaftueshëm se pse ato justifikonin faktin penal dhe si ky fakt penal lidhej me kërkuesin. Nga arsyetimi i vendimeve gjyqësore del qartë sesi gjykatat kanë arritur në përfundimin se nga rrethanat rezulton se vrasjen e ka kryer kërkuesi, i cili ka pasur qëllim ta kryejë atë. Po ashtu, gjykatat i kanë radhitur e përcaktuar qartë faktet më të rëndësishme që lidhen me çështjen për përcaktimin e përgjegjësisë ligjore të kërkuesit, duke mos u bazuar vetëm në provat me dëshmitarë, sikundër pretendon kërkuesi. Në këtë kuptim përgjegjësia ligjore e tij nuk duket të jetë e bazuar në aludime ose dyshime.

63. Lidhur me *mosdhënien të kërkuesit të statusit “të personit të dënuar” (c)*, me argumentin se në gjykimin e tretë, në rigjykim, kërkuesi ka pasur statusin “person i dënuar” dhe jo “i paraburgosur”, në një kohë që gjatë rigjykimit të parë ai është konsideruar “i pandehur” dhe jo i dënuar, Gjykata, referuar vendimeve gjyqësore dhe akteve të tjera në dosje, si procesverbali gjyqësor, vëren se ato i janë referuar kërkuesit si i pandehur dhe jo si i dënuar. Për rrjedhojë, nuk duket që gjykata e shkallës së parë në gjykimin e tretë të ketë shfaqur sjellje paragjyqëse karshi kërkuesit.

64. Për sa i takon *marrjes së provave që e shfajësonin kërkuesin (ç)*, me argumentin se prokuroria dhe gjykata nuk kanë hetuar pista të tjera hetimore mbi autorë të mundshëm, Gjykata, në referencë të vendimeve gjyqësore, vëren se përkundër asaj që pretendon kërkuesi, mbi bazën e kërkesës së tij janë hetuar paralelisht edhe dy pista të tjera. E para lidhej me

dyshimet se autori i veprës mund të ishte shtetasi F.L., vëllai i ish të fejuarës së kërkuesit, për shkak të prishjes së fejesës me kërkuesin, ndërsa pista e dytë lidhej me dyshimet se autori i veprës mund të ishte shtetasi A.M., për shkak të një fejese të porealizuar. Për të dyja këto pista nuk kanë rezultuar të dhëna për ekzistencën e ndonjë konflikti me viktimat ose familjarët e tyre (*shih faqet 92-97 të vendimit të gjykatës së shkallës së parë*). Ndërsa për argumentin se prokuroria nuk ka marrë letërporosi për të kuptuar personalitetin e viktimës në shtetin ku jetonte dhe punonte, Gjykata vlerëson se ai nuk është i mjaftueshëm nga pikëpamja kushtetuese për të vënë në dyshim respektimin e këtij standardi kushtetues gjatë hetimit dhe dënimit të kërkuesit, në kushtet kur nuk ka asnjë shpjegim sesi personaliteti i viktimës mund të ndikonte në prezumimin e pafajësisë së kërkuesit. Për më tepër, as vetë kërkuesi gjatë gjykimit nuk ka kërkuar ose evidentuar ndonjë të dhënë që mund të ndikonte në këtë drejtim.

65. Në analizë të sa më sipër, Gjykata çmon se gjykatat e zakonshme, përfshirë Gjykatën e Lartë, kanë përmbushur detyrimin e tyre kushtetues për respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë në drejtim të ndalimit të paragjyimit të çështjes në ngarkim të kërkuesit. Ato kanë përcaktuar fajësinë e kërkuesit përtej dyshimeve të arsyeshme, bazuar në një mori provash, përmbajtja e të cilave është analizuar dhe arsyetuar mjaftueshëm, pa prezumime fakti të paarsyeshme nga ana e tyre, si dhe nuk kanë zhvendosur barrën e provës te kërkuesi. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të prezumimit të pafajësisë është i pabazuar.

66. Në përfundim, Gjykata çmon se sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi kërkesa është e pabazuar, ndaj dhe ajo rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.04.2026

Shpallur më 09.06.2026

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkues Luan Marra, me objekt: “Shfuqizimi i vendimeve nr. 74, datë 12.03.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë Berat; nr. 22, datë 31.01.2020 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2024-2078 (181), datë 11.07.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën”, ne, gjyqtarët Ilir Toska dhe Genti Ibrahim, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte pranuar, duke u shfuqizuar vendimet gjyqësore objekt ankimi kushtetues individual dhe duke u dërguar çështja për shqyrtim në gjykatën e shkallës së parë.

2. Përpara se të analizojmë pretendimet e kërkuesit në ankimin kushtetues individual objekt shqyrtimi, vlerësojmë të nevojshme të evidentojmë zhvillimin procedural të çështjes, pasi ajo paraqet një proces gjyqësor penal të përsëritur, në të cilin Gjykata është shprehur dy herë më parë për të njëjtin kërkues, për të njëjtën ngjarje penale dhe për të njëjtat akte procedurale. Për këtë arsye, rëndësi vendimtare merr verifikimi nëse në procesin gjyqësor të kundërshtuar janë respektuar përfundimet detyruese të vendimeve të mëparshme të Gjykatës.

Gjykimi fillestar i çështjes

3. Nga aktet e dosjes gjyqësore rezulton se, me vendimin nr. 107, datë 23.05.2008, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat e ka deklaruar kërkuesin fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278, pika 2 të KP-së, duke e dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 117, datë 03.03.2009, e ka lënë në fuqi këtë vendim, ndërsa Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 760, datë 24.06.2010, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

4. Në këtë gjykim, gjykatat e faktit kanë pranuar si të provuar versionin e akuzës, sipas të cilit kërkuesi, mbrëmjen e datës 09.02.2006, pas një debati me vëllain e tij, viktimën Sh.M., lidhur me dyshimet e këtij të fundit për një marrëdhënie intime ndërmjet kërkuesit dhe bashkëshortes së viktimës, është larguar nga banesa e viktimave dhe, pasi ka marrë një armë automatike të fshehur në një ambient pranë banesës, është kthyer sërish dhe pasi ka hyrë në banesë ka shtënë me breshëri në drejtim të viktimave Sh.M., F.M. dhe fëmijës së tyre të mitur A.M., duke shkaktuar vdekjen e tyre. Sipas këtij versioni, pas ngjarjes kërkuesi është larguar nga vendi i ngjarjes dhe e ka hedhur armën në lumin Devoll.

5. Në mbështetje të këtij përfundimi, gjykata e shkallës së parë ka administruar dhe vlerësuar një sërë provash shkresore, shkencore dhe dëshmitare. Ndër provat shkencore kanë qenë: procesverbali i këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe tabelat fotografike, nga të cilat ka rezultuar pozicioni i viktimave në banesë, prania e gëzhjojave dhe predhave, si dhe gjendja e vendit të ngjarjes; akti i ekspertimit balistik, nga i cili ka rezultuar se gëzhhojat ishin qitur nga një armë e vetme zjarri, model 56, kalibër 7.62 mm; aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, nga të cilat ka rezultuar se viktimat kishin pësuar plagë të shumta me armë zjarri dhe se vdekja kishte ardhur si pasojë e këtyre plagëve; akti i ekspertimit biologjik/ADN-së për atësinë e fetusit të viktimës F.M.; akti traseologjik, sipas të cilit gjurma e këpucës e gjetur në vendin e ngjarjes nuk përputhej me këpucët e sekuestruara në banesën e kërkuesit. Megjithatë, këto prova kanë shërbyer kryesisht për përcaktimin e rrethanave objektive të ngjarjes, por jo për identifikimin e drejtpërdrejtë të autorit, për sa kohë arma e krimit nuk është gjetur, gjurma traseologjike nuk e lidhte kërkuesin me vendin e ngjarjes dhe provat shkencore nuk krijojnë, në mënyrë të pavarur, lidhje identifikuese ndërmjet tij dhe aktit të vrasjes.

6. Për këtë arsye, gjykatat e faktit, në përcaktimin e fajësisë së kërkuesit i kanë dhënë peshë të veçantë deklarimeve të tij vetinkriminuese në fazën hetimore dhe eksperimentit hetimor, përmes të cilave është rindërtuar dinamika e ngjarjes dhe është lidhur kërkuesi me veprimet konkrete të kryerjes së veprës. Më konkretisht, gjykata e shkallës së parë ka marrë në shqyrtim deklaratimet e kërkuesit të datës 30.10.2006, të bëra gjatë hetimit, gati 9 muaj pas ngjarjes, në të cilat ai ka pranuar autorësinë e vrasjes, megjithëse në gjykim ai e ka mohuar akuzën dhe ka pretenduar se ato deklaratime i kishte dhënë në kushtet e ushtrimit ndaj tij të dhunës fizike dhe psikike, si dhe pa praninë e mbrojtësit. Për këtë pretendim të kërkuesit, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar edhe dëshmitë e punonjësve të Policisë Gjqësore S.B. dhe E.Z., të cilët kanë mohuar ushtrimin e dhunës fizike ose psikike ndaj kërkuesit. Gjithashtu, gjykata ka vlerësuar edhe dëshminë e avokatit Q.B., i cili ka deklaruar se në datën 30.10.2006, pasdite, është thirrur nga policia për të marrë pjesë në pyetjen e kërkuesit. Megjithatë, sipas tij, ai nuk ka qenë i pranishëm kur kërkuesi është pyetur. Pavarësisht kësaj, ai ka deklaruar se e ka nënshkruar procesverbalin e pyetjes, pasi më parë e kishte pyetur kërkuesin nëse e kishte firmosur ai atë procesverbal dhe nëse e kishte kryer ai krimin, duke marrë prej tij përgjigje pohuese.

7. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka administruar si provë transkriptimin dhe materialet shoqëruese të eksperimentit hetimor të datës 30.10.2006, në të cilin kërkuesi ka treguar veprimet që, sipas organit të akuzës, kishte kryer ditën e ngjarjes, konkretisht vendin ku ndodhej arma, marrjen e saj, hyrjen në banesën e viktimave, hapjen e derës, qitjen me

breshëri, largimin nga vendi i ngjarjes dhe vendin ku e kishte hedhur armën në lumë, e cila, pavarësisht kërkimeve, nuk është gjetur në atë vend dhe as në ndonjë vend tjetër.

8. Në këtë mënyrë, gjykata e shkallës së parë ka pranuar se deklaratimet vetinkriminuese dhe eksperimenti hetimor mund të përdoren në proces dhe, së bashku me provat e tjera të administruara, ka arritur në përfundimin se fajësia e kërkuesit provohej tej çdo dyshimi të arsyeshëm.

9. Edhe gjykata e apelit, pas shqyrtimit të çështjes mbi ankimin e kërkuesit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke pranuar se ky vendim ishte rrjedhojë e zbatimit të drejtë të ligjit dhe i bazuar në prova. Në arsyetimin e saj gjykata e apelit ka ritheksuar se rrethanat e ngjarjes provoheshin nga provat shkresore, provat shkencore, deklaratimet e kërkuesit dhe shpjegimet e dëshmitarëve të administruara në gjykim. Ajo ka riprodhuar, në thelb, të njëjtën bazë provuese, duke përfshirë edhe deklaratimet e kërkuesit në hetim dhe eksperimentin hetimor, të cilat ai i kishte kundërshtuar si të marra nën dhunë.

10. Për rrjedhojë, në gjykimin e parë, pavarësisht ekzistencës së provave shkencore dhe me dëshmitarë, si akte me rëndësi vendimtare për lidhjen e kërkuesit me autorësinë e veprës, kanë shërbyer procesverbali i pyetjes/deklaratimet vetinkriminuese të datës 30.10.2006 dhe eksperimenti hetimor i së njëjtës datë. Provat e tjera, në pjesën më të madhe, kanë shërbyer për të konfirmuar rrethanat objektive të ngjarjes ose për të mbështetur motivin e pretenduar, ndërsa dinamika e plotë e kryerjes së veprës dhe identifikimi i kërkuesit si autor janë ndërtuar kryesisht mbi aktet e sipërpërmendura.

11. Pas përfundimit të procesit gjyqësor, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit, ai i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, duke pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor, në veçanti për shkak të marrjes së deklaratimeve vetinkriminuese pa praninë efektive të mbrojtësit, përdorimit të dhunës gjatë marrjes në pyetje, shkeljes të së drejtës për të mos u vetinkriminuar dhe përdorimit të provave të marra në mënyrë të paligjshme. Me vendimin nr. 14, datë 03.05.2011 (*vendimi nr. 14/2011*), Gjykata e ka pranuar kërkesën, duke shfuqizuar vendimet e gjykatave të zakonshme dhe duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Në këtë vendim Gjykata ka bërë një dallim të qartë ndërmjet vlerësimit të provave, që si rregull u takon gjykatave të zakonshme, dhe mënyrës së marrjes e fiksimit të tyre, e cila i nënshtrohet kontrollit kushtetues kur pretendohet se provat janë marrë në kundërshtim me garancitë themelore të procesit të rregullt.

12. Lidhur me të drejtën e mbrojtjes, Gjykata ka vlerësuar se në momentin kur personi që pyetet bën deklaratime nga të cilat mund të burojnë përgjegjësi penale, organi procedues duhet të ndërpresë pyetjen dhe të sigurojë praninë efektive të mbrojtësit përpara vazhdimin të saj. Ajo

ka theksuar se fakti që neni 37 i KPP-së parashikon ftesën që i bëhet personit që po merret në pyetje që të zgjedhë një mbrojtës nuk mund të lexohet në mënyrën që e ka interpretuar gjykata e faktit. Sipas Gjykatës, prania e mbrojtësit nuk mund të zëvendësohet nga një verifikim i mëvonshëm formal i deklarimeve të dhëna, pasi mbrojtësi duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarit dhe, mbi të gjitha, duhet që në çdo rast të kujdeset për interesat e të ndaluarit. Për këtë arsye, Gjykata ka arritur në përfundimin se në rastin e kërkuesit është cenuar neni 31 i Kushtetutës.

13. Për pretendimin e dhunës dhe përdorimin e deklarimeve vetinkriminuese të marra përmes saj, Gjykata ka mbajtur parasysh se akti i ekspertimit mjeko-ligjor, i kryer me kërkesën e prokurorit, ka konstatuar dëmtime në trupin e kërkuesit, përkatësisht ekimoza në nofull dhe në shputat e këmbëve. Megjithatë, ajo ka vërejtur se as organi i prokurorisë, as gjykatat e zakonshme nuk kanë përmbushur detyrimet që burojnë edhe nga Konventa kundër Torturës dhe Akteve Çnjerëzore dhe Degraduese, pasi nuk kanë ndërmarrë hapat e nevojshëm dhe të domosdoshëm për të kërkuar dhe sqaruar deri në fund origjinën e këtyre dëmtimeve dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ishte marrë në pyetje. Në këtë drejtim, Gjykata ka theksuar se ka dyshime serioze për kushtet dhe rrethanat në të cilat kërkuesi ka pohuar fajësinë e tij, për rrjedhojë edhe për përmbushjen e standardeve për proces të rregullt ligjor lidhur me mënyrën e marrjes së provave. Sipas saj, jo vetëm që ka dyshime serioze se ndaj kërkuesit është ushtruar dhunë për të marrë pohimin e tij, por nga ai pretendohet se është detyruar të dëshmojë kundër vetvetes, në kundërshtim me ndalimet që burojnë nga nenet 25 dhe 32 të Kushtetutës. Po ashtu, Gjykata ka çmuar të papranueshme që akuza të mbështetet kryesisht në deklaratimet e një personi, i cili jo vetëm është marrë në pyetje pa praninë e avokatit, por pretendon edhe se deklaratimet i ka dhënë për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tij. Gjithashtu, ajo ka theksuar se deklaratimet e bëra para prokurorit ose Policisë Gjyqësore nuk përbëjnë prova në vetvete dhe, në kuptim të nenit 362 të KPP-së, ato vlerësohen nga gjykata për të përcaktuar besueshmërinë e personit të pyetur. Nga ana tjetër, po sipas saj, deklaratimet e dhëna përpara organeve proceduese mund të vlerësohen vetëm nëse lidhen me prova të tjera që konfirmojnë vërtetësinë e tyre.

14. Në lidhje me eksperimentin hetimor, Gjykata ka konstatuar se ai është kryer nga organet e policisë menjëherë pas vetinkriminimit të kërkuesit dhe në rrethana që krijojnë dyshime serioze për ligjshmërinë e tij, për më tepër pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit. Për këtë arsye, Gjykata ka vlerësuar se ky veprim hetimor jo vetëm krijonte dyshime serioze për ligjshmërinë e tij, por binte ndesh edhe me standardin kushtetues për mënyrën e marrjes dhe vlerësimit të provave.

Gjykimi i dytë i çështjes (rigjykimi i parë)

15. Pas vendimit nr. 14/2011 të Gjykatës, çështja është rigjykuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila, me vendimin nr. 123, datë 02.03.2012, e ka deklaruar përsëri kërkuesin fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278, pika 2 të KP-së, duke e dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 328, datë 27.06.2012, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-1593, datë 06.11.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesit.

16. Në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se rigjykimi i çështjes është zhvilluar si pasojë e shfuqizimit të vendimeve të mëparshme nga Gjykata dhe ka cituar pjesë të arsyetimit të vendimit nr. 14/2011 lidhur me dallimin ndërmjet mënyrës së marrjes së provave dhe vlerësimit të tyre, me rëndësinë e pranisë së mbrojtësit gjatë veprimeve hetimore, me ndalimin e përdorimit të deklarimeve të marra në cenim të garancive procedurale, si dhe me detyrimin për të sqaruar pretendimet e kërkuesit për ushtrim dhune. Në këtë drejtim, gjykata ka vlerësuar se, në zbatim të vendimit të Gjykatës, asaj i ishte lënë detyrë të kryente një hetim të plotë dhe të gjithanshëm për rrethanat e pretenduara nga kërkuesi, veçanërisht për shkaqet e dëmtimeve të konstatuara në trupin e tij.

17. Në vijim, gjykata e shkallës së parë ka pranuar përsëri të njëjtin version faktik të akuzës. Ajo ka analizuar provat shkresore dhe shkencore të administruara edhe në gjykimin e parë, të tilla si këqyrja e vendit të ngjarjes, aktet e ekspertimit balistik, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor, gjurma traseologjike, aktet për krahasimin e saj me këpucët e sekuestruara në banesën e kërkuesit, si dhe provat që lidheshin me shkakun dhe harkun kohor të vdekjes së viktimave. Sipas gjykatës, këto prova shërbenin për të provuar rrethanat objektive të ngjarjes, përfshirë vendndodhjen e viktimave, mënyrën e vrasjes, numrin dhe llojin e predhave, kalibrin e armës dhe drejtimin e qitjes.

18. Në rigjykim, krahas këtyre provave, gjykata e shkallës së parë ka marrë dhe analizuar edhe prova të tjera, ndër të cilat dëshmitë e familjarëve dhe të personave të tjerë për lëvizjet e kërkuesit dhe viktimës ditën e ngjarjes, për kohën e mundshme të vrasjes, për zhurmat e dëgjuara pasditen ose mbrëmjen e ngjarjes, si dhe për pista të tjera të mundshme hetimore. Në këtë kuadër, gjykata ka trajtuar edhe pretendimet që lidheshin me shtetasin A.M., duke evidentuar, ndër të tjera, se arma e sekuestruar atij nuk përputhej me gëzhojat e gjetura në banesën e viktimave. Megjithatë, nga arsyetimi i gjykatës rezulton se rëndësi të veçantë për ndërtimin e versionit të fajësisë së kërkuesit kanë marrë përsëri aktet e datës 30.10.2006, konkretisht procesverbali i pyetjes së kërkuesit dhe eksperimenti hetimor i zhvilluar po atë datë.

19. Për eksperimentin hetimor, gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se ky akt ishte kërkuar të administrohej edhe nga mbrojtja e kërkuesit, ndërsa në të kishin marrë pjesë punonjës të Policisë Gjyqësore dhe ekspertë, të cilët janë pyetur edhe si dëshmitarë në gjykim. Sipas gjykatës, nga këto akte dhe dëshmi rezultonte mekanizmi i ngjarjes i treguar nga kërkuesi gjatë eksperimentit, përfshirë marrjen e armës pranë banesës së viktimës, hyrjen në banesë, pozicionin e viktimave, mënyrën e qitjes me armë, largimin nga vendi i ngjarjes dhe hedhjen e armës në lumë. Sipas saj, dëshmitë e personave që kishin marrë pjesë në eksperimentin hetimor përshkruanin një komunikim të qetë me kërkuesin, mungesë kundërshtimesh prej tij dhe mungesë pyetjesh sugjestionuese nga ana e punonjësve të policisë.

20. Për sa i përket procesverbalit të pyetjes së kërkuesit të datës 30.10.2006, gjykata e shkallës së parë ka evidentuar pretendimin e mbrojtjes për pavlefshmërinë absolute të tij, me argumentin se pyetja ishte kryer pa praninë efektive të mbrojtësit dhe në kushtet e dhunës fizike e psikike, me qëllim që kërkuesi të pohonte fajësinë. Në lidhje me këtë pretendim, gjykata ka mbajtur parasysh se, sipas vendimit nr. 14/2011, kërkuesi ishte marrë në pyetje në mjedise policore pa praninë efektive të mbrojtësit, ndërsa ky i fundit ishte thirrur më pas dhe kishte nënshkruar deklaratimet. Pikërisht për këtë arsye, duke e konsideruar këtë rrethanë të përcaktuar nga vendimi i Gjykatës, por edhe si të provuar në rigjykim, gjykata e shkallës së parë ka rrëzuar kërkesën e prokurorit për pyetjen si dëshmitar të avokatit Q.B.

21. Megjithatë, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se procesverbali i datës 30.10.2006 nuk ishte kërkuar të lejohej si provë nga prokurori, as në kuadër të kërkesave për prova, as gjatë shqyrtimit gjyqësor, ndaj nuk ishte administruar dhe nuk ishte debatuar si provë fajësie. Sipas gjykatës, ky procesverbal ndodhej në fashikullin e prokurorit dhe, pas pyetjes së kërkuesit në gjykim, prokurori kishte kërkuar përdorimin e tij vetëm për kundërshtimin e deklaratimeve të dhëna nga kërkuesi në seancë. Gjykata e shkallës së parë e ka pranuar këtë kërkesë, duke iu referuar nenit 370, pika 1 të KPP-së. Në këtë kuadër, ajo ka bërë dallimin ndërmjet përdorimit të procesverbalit si provë fajësie dhe përdorimit të tij për kundërshtimin e deklaratimeve të kërkuesit në gjykim. Sipas saj, kundërshtimi i deklaratimeve me procesverbalin e datës 30.10.2006 nuk kishte për qëllim marrjen e këtij akti si provë për fajësinë, por vetëm vlerësimin e besueshmërisë së deklaratimeve të kërkuesit në gjykim. Gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se, ndryshe nga rregullimi për deklaratimet e dëshmitarëve, neni 370 i KPP-së nuk parashikon që deklaratimet e mëparshme të të pandehurit të marrin vlerën e provës në rast kundërshtimi, por lejon përdorimin e tyre për të vlerësuar besueshmërinë e deklaratimeve të dhëna para gjykatës. Po ashtu, ajo ka vlerësuar se prania e mbrojtësit nuk ishte kusht i domosdoshëm për përdorimin e deklaratimeve të mëparshme në kuadër të nenit 370, pika 1 të KPP-së, për sa kohë nuk kërkohej leximi i tyre si provë në kuptim të nenit 370, pika 2, por

vetëm kundërshtimi i thënieve të kërkuarit pas pyetjes së tij në gjykim. Për këtë arsye, gjykata e shkallës së parë ka çmuar se deklaratimet e datës 30.10.2006 mund të përdoren për të vënë në dyshim besueshmërinë e deklaratimeve të kërkuarit në seancë, si për pretendimin për dhunë nga policia, ashtu edhe për mohimin e akuzës.

22. Në lidhje me pretendimin për ushtrim dhune, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se hetimi i këtij pretendimi ishte një nga detyrat e lëna nga Gjykata. Për këtë qëllim, gjatë rigjyqimit janë pyetur punonjësit e policisë që kishin marrë pjesë në veprimet procedurale, të cilët kanë mohuar ushtrimin e dhunës ndaj kërkuarit dhe familjarëve të tij. Po ashtu, gjykata e shkallës së parë ka administruar si provë edhe vendimin e datës 31.07.2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me të cilin ishte pushuar procedimi penal i regjistruar mbi pretendimet për ushtrim dhune ndaj kërkuarit dhe familjarëve të tij nga punonjës të policisë dhe prokurorisë. Për pretendimin se kërkuari ishte goditur me shkop, gjykata e shkallës së parë ka mbajtur parasysh se, sipas ekspertit mjeko-ligjor, mjeti i fortë mprehës mund të ishte edhe shkopi, por nuk mund të jepej një përgjigje absolute për rastin konkret. Megjithatë, ajo ka vlerësuar se koha e dëmtimeve të konstatuara të kërkuarit përfshihej në intervalin 24-orësh nga fillimi i ekzaminimit mjeko-ligjor, i cili kishte nisur në orën 15:30 të datës 31.10.2006, ndërsa pyetja e kërkuarit dhe zhvillimi i eksperimentit hetimor ishin kryer paraditen e datës 30.10.2006. Mbi këtë bazë, si dhe duke iu referuar dëshmive të punonjësve të policisë dhe vendimit të pushimit të procedimit penal, gjykata ka arritur në përfundimin se pretendimi për marrjen e deklaratimeve dhe zhvillimin e eksperimentit hetimor nën ndikimin e dhunës nuk mbështetej në provat e administruara.

23. Në përfundim, gjykata e shkallës së parë ka çmuar se fajësia e kërkuarit provohet nga tërësia e provave dhe indicieve të administruara në proces, duke përfshirë provat shkencore, dëshmitë e marra në gjykim, aktet shkresore, kundërshtimin e deklaratimeve të kërkuarit, si dhe eksperimentin hetimor të datës 30.10.2006. Sipas saj, këto prova dhe indicie, të vlerësuara në unitet me njëra-tjetrën, provonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm ndodhjen e veprës penale dhe autorësinë e kërkuarit.

24. Nga ana e saj, gjykata e apelit, pas shqyrtimit të çështjes mbi ankimin e kërkuarit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë, duke vlerësuar se ai ishte i drejtë, i bazuar në ligj dhe në prova. Sipas gjykatës së apelit, nga tërësia e akteve të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, rezultonte se veprat penale provoheshin në të njëjtat rrethana fakti të pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Ajo ka vlerësuar se çmuarja e provave është bërë në përputhje me nenet 149 dhe 152 të KPP-së dhe se nga vlerësimi i tyre në tërësi dhe harmoni provohet mekanizmi i ngjarjes. Në këtë kuadër, gjykata e apelit u është referuar akteve procedurale të mbajtura në vendngjarje, provave materiale, ekspertimeve mjeko-ligjore dhe

balistike, deklarimeve të dëshmitarëve, pohimeve të kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake, si dhe procesverbalit të eksperimentit hetimor, përmes të cilave, sipas saj, identifikohet kërkuesi si autor i veprave penale.

25. Për sa u përket pretendimeve për moszbatimin e vendimit nr. 14/2011 të Gjykatës, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka marrë në analizë pretendimet për ushtrim dhune dhe torturë, duke marrë prova për të sqaruar rrethanat konkrete sipas orientimeve të lëna në rigjykim. Ajo ka evidentuar se në rigjykim është administruar vendimi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë për pushimin e procedimit penal të regjistruar mbi pretendimet e kërkuesit dhe familjarëve të tij për dhunë, në kuadër të të cilit ishte pyetur edhe avokati Q.B., i cili, sipas gjykatës së apelit, ka pohuar se është thirrur për të qenë mbrojtës i kërkuesit që në momentin kur ai kishte pranuar autorësinë e ngjarjes, se ka vijuar me procedurat e pyetjes dhe nënshkrimit të procesverbalit dhe se ky procesverbal ishte nënshkruar me vullnet të lirë edhe nga kërkuesi. Gjykata e apelit ka vlerësuar se kjo dëshmi rrëzonte pretendimin se deklaratimet e datës 30.10.2006 janë dhënë nën ushtrimin e dhunës ose torturës.

26. Në lidhje me dëmtimet e konstatuara të kërkuesi, gjykata e apelit ka mbajtur parasysh aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. 269, datë 31.10.2006, ora 15:30, sipas të cilit të kërkuesi ishin konstatuar ekimoza në nofull dhe në shputën e këmbës së djathtë, të shkaktuara me mjete të forta mprehëse, të vlerësuara si dëmtime të parëndësishme për jetën dhe të shkaktuara brenda një harku kohor 24 orësh nga momenti i ekzaminimit. Megjithatë, gjykata e apelit ka çmuar se nuk provohej që këto dëmtime të ishin shkaktuar nga punonjësit e policisë gjatë marrjes së deklaratimeve, aq më pak që ato të kishin qenë të tilla sa ta detyronin kërkuesin të pranonte autorësinë e krimit. Sipas saj, nga aktet rezultonte se ndalimi i kërkuesit ishte kryer në orën 10:00 të datës 30.10.2006, pas deklaratimeve të dhëna prej tij, ndërsa, duke iu referuar harkut kohor të përcaktuar në aktin mjeko-ligjor, dëmtimet rezultojnë të ishin shkaktuar pas orës 15:30 të datës 30.10.2006. Gjykata e apelit ka shtuar se kjo rrethanë nuk përjashtonte as mundësinë e simulimit të dëmtimeve nga vetë kërkuesi ose të shkaktimit të tyre nga persona të tjerë gjatë qëndrimit të tij të izoluar. Po ashtu, gjykata e apelit ka analizuar pretendimin e kërkuesit se ishte mbajtur disa ditë i izoluar dhe i dhunuar përpara se të pranonte autorësinë, duke arritur në përfundimin se ky pretendim nuk provohej. Sipas saj, nga hetimet e zhvilluara në procedimin penal nr. 161 të vitit 2009 rezultonte se kërkuesi ishte thirrur në datat 13.10.2006 dhe 29.10.2006, ndërsa kishte pranuar autorësinë më 30.10.2006, çka, sipas gjykatës së apelit, përjashtonte pretendimin se ka qenë përreth 4-5 ditë i izoluar dhe i dhunuar fizikisht.

27. Gjykata e apelit ka përdorur si argument edhe përputhjen e detajeve të dhëna nga kërkuesi me të dhënat e vendngjarjes. Sipas saj, nëse pretendimet për marrjen e deklaratimeve nën dhunë do të ishin të besueshme, nuk do të shpjegohej sesi përgjigjet e kërkuesit, të cilat ai

i cilësonte të improvizuara dhe të dhëna nën efektin e dhunës, përputheshin me rrethanat e fiksuara në procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes, tabelën fotografike dhe aktet e ekzaminimit të kufomave, përfshirë pozicionin e viktimave, plagët e marra dhe mënyrën e qitjes. Për këtë arsye, gjykata e apelit ka arritur në përfundimin se pretendimet për dhunë dhe torturë, si gjatë marrjes së deklarimeve të datës 30.10.2006, ashtu edhe gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor janë të pavërteta.

28. Për procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006, gjykata e apelit ka arsyetuar në dy drejtime. Nga njëra anë, ajo ka pranuar se, ndryshe nga arsyetimi i gjykatës së shkallës së parë që nuk e kishte lejuar këtë akt si provë dhe nuk kishte pranuar kërkesën për pavlefshmërinë e tij për këtë shkak, procesverbali përbënte një akt të rëndësishëm të fazës së hetimeve paraprake, me rëndësi të veçantë procedurale. Në këtë drejtim, ajo i është referuar nenit 370 të KPP-së, sipas të cilit, për të kundërshtuar tërësisht ose pjesërisht përmbajtjen e deklarimeve të të pandehurit, palët mund të përdorin deklaratimet e bëra më parë prej tij që ndodhen në fashikullin e prokurorit, nëse ai ka folur për faktet dhe rrethanat që kundërshtohen. Nga ana tjetër, gjykata e apelit ka pranuar se ishte e detyruar të zbatonte përfundimin e vendimit nr. 14/2011 të Gjykatës, sipas të cilit deklaratimet e datës 30.10.2006 ishin marrë pa praninë e mbrojtësit, në kundërshtim me nenin 37 të KPP-së, dhe, për këtë shkak, procesverbali i deklarimeve të kërkuesit, i dhënë në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime, ishte akt absolutisht i pavlefshëm.

29. Për sa i përket eksperimentit hetimor, gjykata e apelit ka vlerësuar se prania e mbrojtësit nuk ka qenë e detyrueshme për kryerjen e këtij veprimi procedural. Duke qenë se, sipas saj, pretendimet e kërkuesit për dhunë dhe torturë gjatë zhvillimit të eksperimentit hetimor kishin rezultuar të pavërteta, gjykata e apelit ka çmuar si të pabazuar kërkesën e tij për deklarimin e këtij akti si absolutisht të pavlefshëm. Për rrjedhojë, ajo ka konfirmuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë se eksperimenti hetimor mund të vlerësohej në proces.

30. Çështja në vijim është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi rekursin e kërkuesit, në të cilin ai ka ngritur pretendime në lidhje me moszbatimin e vendimit nr. 14/2011 të Gjykatës, përdorimin e provave të marra në kundërshtim me ligjin dhe standardet kushtetuese, të drejtën e mbrojtjes dhe ndalimin e vetinkriminimit. Megjithatë, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit.

31. Në këto kushte, kërkuesi ka paraqitur përsëri ankim kushtetues individual, duke pretenduar se rigjykimi i çështjes së tij kishte riprodhuar të njëjtat shkelje të konstatuara në vendimin e Gjykatës nr. 14/2011. Sipas tij, gjykatat e zakonshme nuk kishin respektuar efektin detyrues të këtij vendimi, kishin përdorur përsëri aktet e kontestuara, nuk kishin sqaruar në

mënyrë të plotë pretendimet për dhunë dhe kishin mbështetur fajësinë e tij në deklarime të marra në kundërshtim me garancitë ligjore dhe kushtetuese.

32. Me vendimin nr. 20, datë 04.04.2016 (*vendimi nr. 20/2016*), Gjykata e ka vlerësuar të bazuar pretendimin e kërkuesit për mosrespektimin dhe moszbatimin e vendimit të saj nr. 14/2011. Gjykata ka theksuar se pretendimet e kërkuesit lidheshin me të drejtën e mbrojtjes dhe me ligjshmërinë e marrjes së provave, në vështrim të standardeve kushtetuese që imponon e drejta për proces të rregullt ligjor dhe të detyrimeve që rridhnin nga vendimi i saj nr. 14/2011 për korrigjimin e shkeljeve të konstatuara më parë.

33. Lidhur me procesverbalin e deklarimeve të datës 30.10.2006, Gjykata ka vlerësuar se, për shkak të mënyrës së marrjes së tij, ai ishte një akt absolutisht i pavlefshëm në kuptim të nenit 128, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së dhe nuk mund të përdorej nga prokuroria për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, deklaratimet e kërkuesit në gjykim. Gjykata ka theksuar se deklaratimet e bëra nga kërkuesi duke inkriminuar veten pa praninë e mbrojtësit nuk mund të shfrytëzoheshin kundër tij dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përdreshin as për efekt kundërshtimi ose besueshmërie.

34. Për sa i përket eksperimentit hetimor, Gjykata ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë e kishte përdorur atë si provë kryesore për të konkluduar për fajësinë e kërkuesit, megjithëse në vendimin nr. 14/2011 ajo ishte shprehur për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së kësaj prove. Gjykata ka vënë në dukje se eksperimenti hetimor është zhvilluar në rrethana ku kërkuesi ka inkriminuar veten, pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit, si dhe në kushte që ngrinin dyshime për ushtrim dhune ndaj tij dhe që kërkonin hetim nga autoritetet. Gjykata nuk ka pranuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë se eksperimenti hetimor mund të vlerësohej si provë për shkak se administrimi i tij ishte kërkuar edhe nga mbrojtësi i kërkuesit. Ajo ka vërejtur se mbrojtësi ka kërkuar administrimin e kësaj prove për të provuar dhunën, kanosjen dhe kërcënimin nga Policia Gjyqësore, ndërkohë që gjykata e shkallës së parë e ka përdorur atë si provë kryesore për të provuar fajësinë e kërkuesit. Kjo mënyrë përdorimi, sipas Gjykatës, ishte e papajtueshme me standardin kushtetues të vendosur në vendimin e saj nr. 14/2011.

35. Për rrjedhojë, Gjykata ka arritur në përfundimin se gjykata e shkallës së parë nuk kishte respektuar detyrimet që rridhnin nga vendimi nr. 14/2011 dhe se procesi i rigjyimit nuk respektonte kërkesat e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, ajo ka konstatuar se këto shkelje nuk janë korrigjuar as nga gjykata e apelit, as nga Gjykata e Lartë. Në këtë mënyrë, sipas Gjykatës, moszbatimi i vendimit nr. 14/2011 dhe mosriparimi i shkeljeve të konstatuara në atë vendim e bënë të parregullt në tërësi procesin gjyqësor të rigjyimit të çështjes. Për këtë arsye, Gjykata ka pranuar kërkesën e kërkuesit, duke shfuqizuar vendimet e kundërshtuara të gjykatave të zakonshme dhe duke e dërguar çështjen për rishqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat.

Gjykimi i tretë i çështjes (rigjykimi i dytë) - objekt i ankimit kushtetues individual

36. Në vijim të vendimit nr. 20/2016 të Gjykatës, çështja është (ri)gjykuar për herë të tretë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila, me vendimin nr. 74, datë 12.03.2018, e ka deklaruar përsëri kërkuesin fajtor për kryerjen e veprave penale “Vrasja në rrethana të tjera cilësuese” dhe “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79, shkronjat “a”, “b” dhe “dh”, si dhe 278, pika 2 të KP-së, duke e dënuar përfundimisht me burgim të përjetshëm. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. 22, datë 31.01.2020, ndërsa Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-2078 (181), datë 11.07.2024, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.

37. Në vendimin e saj gjykata e shkallës së parë fillimisht ka evidentuar ecurinë procedurale të çështjes, duke cituar edhe pjesë të arsyetimit të vendimeve të Gjykatës nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016, përmes të cilave vendimet e mëparshme gjyqësore ishin shfuqizuar dhe çështja i ishte dërguar asaj për rishqyrtim. Në vijim, gjykata ka marrë në shqyrtim në thelb të njëjtën ngjarje, të njëjtin version faktik të akuzës dhe një pjesë të konsiderueshme të të njëjtave prova të administruara edhe në gjykimet e mëparshme. Kështu, ajo ka analizuar procesverbalin e këqyrjes së vendit të ngjarjes dhe tabelat fotografike, aktin e ekspertimit balistik, aktet e ekspertimit mjeko-ligjor për viktimat, aktin e ekspertimit gjenetik për atësinë e fetusit të viktimës F.M., aktet traseologjike për gjurmën e këpucës, si dhe deklaratimet e dëshmitarëve lidhur me marrëdhëniet familjare, motivin e pretenduar të konfliktit dhe rrethanat e tjera të ngjarjes. Sikurse edhe në gjykimet e mëparshme, këto prova kanë shërbyer kryesisht për të përcaktuar rrethanat objektive të ngjarjes, si vendin, mënyrën dhe kohën e përafërt të vdekjes, mjetin e përdorur, numrin e predhave, pozicionin e viktimave dhe raportet ndërmjet kërkuesit dhe viktimave.

38. Po ashtu, në analizën e saj gjykata e shkallës së parë ka marrë në konsideratë edhe aktet e fazës fillestare të hetimit paraprak, konkretisht: procesverbalin e datës 29.10.2006, kur kërkuesi është pyetur fillimisht si person që ka dijeni për veprën penale; procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006, në cilësinë e personit ndaj të cilit zhvillohen hetime; procesverbalin e pyetjes së datës 31.10.2006, në cilësinë e personit të ndaluar dhe në prani të mbrojtësit, ku kërkuesi ka mohuar autorësinë e vrasjes, por ka dhënë shpjegime për mekanizmin e ngjarjes, duke pretenduar se këtë version e ka improvizuar për shkak të dhunës së ushtruar ndaj tij.

39. Në lidhje me aktet e kontestuara më parë nga Gjykata, gjykata e shkallës së parë ka bërë dallim ndërmjet eksperimentit hetimor të datës 30.10.2006 dhe procesverbalit të pyetjes së kërkuesit të së njëjtës datë. Për eksperimentin hetimor, me vendim të ndërmjetëm të marrë në seancën e datës 20.07.2016, ajo ka vendosur të mos lejojë marrjen si provë të rezultateve të tij, përfshirë procesverbalin e transkriptimit, regjistrimet audio-video, tabelat fotografike dhe aktet e tjera të lidhura me këtë veprim hetimor, me arsyetimin se këto prova ishin siguruar në shkelje të ligjit dhe duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat të personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetime. Sipas gjykatës, pavarësisht se ky veprim ishte konsideruar si eksperiment hetimor për verifikimin në terren të thënieve të personit ndaj të cilit zhvilloheshin hetime, në thelb gjatë tij kërkuesit i ishin marrë deklarime për faktin penal, pa iu bërë e ditur e drejta për t'u asistuar nga mbrojtësi. Po ashtu, gjykata ka pranuar se ky përfundim rezultonte edhe nga vendimet e Gjykatës nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016.

40. Ndërsa për sa i përket procesverbalit të pyetjes së kërkuesit të datës 30.10.2006, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se prokuroria nuk kishte kërkuar marrjen e tij si provë në fazën e kërkesave paraprake, ndaj kërkesa e mbrojtjes për deklarin e pavlefshmërisë së tij ishte pa objekt në atë moment procedural. Megjithatë, gjatë shqyrtimit gjyqësor, kur prokuroria ka kërkuar kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit në gjykim me deklarinet e bëra prej tij gjatë hetimit, gjykata ka lejuar përdorimin e këtij procesverbalit për këtë qëllim, referuar nenit 370, pika 1 të KPP-së. Ajo ka vlerësuar se procesverbalit është hartuar në praninë e avokatit Q.B. dhe është nënshkruar nga kërkuesi dhe avokati, duke e konsideruar këtë fakt të provuar nga përmbajtja e aktit, nënshkrimet në të, dëshmia e oficerit të Policisë Gjyqësore që kishte marrë deklarinet dhe dëshmia e avokatit Q.B.

41. Në lidhje me dëshminë e avokatit Q.B., gjykata e shkallës së parë ka evidentuar se ai ka deklaruar se e ka parë kërkuesin, ka folur me të dhe se kërkuesi “bënte po”. Sipas dëshmisë së pasqyruar në vendim, oficeri i policisë S.B. i drejtonte pyetje kërkuesit, ndërsa ky i fundit pranonte rrethanat që i parashtrheshin, duke pohuar, ndër të tjera, se e kishte kryer vrasjen dhe se armën e kishte hedhur në lumë. Dëshmitari ka deklaruar se, pasi kishte përfunduar procedura, kërkuesit i ishte thënë të firmoste, ai kishte firmosur dhe më pas kishte firmosur edhe vetë avokati. Po ashtu, i pyetur nga mbrojtja për faktin se kishte deklaruar se kishte parë një procesverbal në momentin që kishte shkuar në polici, Q.B. është përgjigjur se kishte parë “një faqe e pak”, që më pas u bë katër faqe; se procesverbalit fillimisht kishte qenë me dorë dhe pastaj ishte shkruar me makinë; se, në praninë e tij, ishin bërë “ato pyetje dhe të tjera”. Për rrjedhojë, gjykata ka vlerësuar se pretendimi i kërkuesit për mungesën e mbrojtësit dhe për nënshkrimin e pavullnetshëm nuk mbështetej në provat e administruara dhe se procesverbalit i

datës 30.10.2006 ishte i përdorshëm në kuadër të kundërshtimit të deklarimeve të kërkuesit në gjykim.

42. Për sa i përket pretendimit për ushtrim dhune fizike ose psikologjike, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se ky pretendim shqyrtohej në funksion të detyrave të lëna nga vendimet e Gjykatës. Në këtë drejtim, ajo ka marrë në analizë, së pari, dëshmitë që lidheshin me rrethanat e marrjes së deklarimeve të datës 30.10.2006 dhe të zhvillimit të eksperimentit hetimor, duke përfshirë dëshminë e oficerit të Policisë Gjyqësore S.B., të avokatit Q.B. dhe të personave që kishin marrë pjesë në veprimin hetimor, të cilët kanë deklaruar se gjatë këtyre veprimeve nuk kishin konstatuar ushtrim dhune fizike ose psikologjike ndaj kërkuesit, se ai kishte komunikuar qetësisht, nuk kishte paraqitur kundërshtime dhe nuk kishte shfaqur shenja frike ose presioni. Së dyti, gjykata ka marrë në konsideratë aktin e ekspertimit mjeko-ligjor për dëmtimet e konstatuara te kërkuesi, si dhe pretendimet e tij dhe të familjarëve për dhunë. Së treti, ajo ka vlerësuar edhe vendimin e datës 31.07.2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, me të cilin ishte pushuar procedimi penal i regjistruar mbi pretendimet për ushtrim dhune ndaj kërkuesit dhe familjarëve të tij, duke theksuar se ndaj këtij vendimi nuk është paraqitur ankim në gjykatë. Mbi bazën e këtyre elementeve, gjykata ka arritur në përfundimin se nuk provohej që deklaratimet e datës 30.10.2006 ose pjesëmarrja e kërkuesit në veprimet procedurale të asaj date të ishin rezultat i dhunës fizike ose psikologjike.

43. Gjykata e shkallës së parë ka përdorur si argument edhe përputhjen e detajeve të dhëna nga kërkuesi me të dhënat objektive të vendngjarjes. Sipas saj, deklaratimet e kërkuesit të datës 31.10.2006, edhe nëse do të merreshin të shkëputura nga deklaratimet e datës 30.10.2006, përmbanin një përshkrim të saktë dhe të përputhur me provat shkencore dhe aktet e vendngjarjes, përfshirë hyrjen në banesë, goditjen e derës me këmbë, pozicionin e viktimave, mënyrën e qitjes, drejtimin e qitjes, mënyrën sesi kishin rënë viktimat, si dhe të dhënat e këqyrjes së vendit të ngjarjes, tabelës fotografike, gjurmës traseologjike dhe ekspertimeve mjeko-ligjore. Për këtë arsye, gjykata ka vlerësuar se një përshkrim i tillë i detajuar dhe i përputhur me provat objektive vështirë se mund të shpjegohej si rezultat i fantazisë ose improvizimit të kërkuesit, ose si rezultat i deklaratimeve të imponuara nga dhuna. Mbi këtë bazë, ajo ka arritur në përfundimin se nuk provohej që deklaratimet e datës 30.10.2006, deklaratimet e mëvonshme ose pjesëmarrja e kërkuesit në veprimet procedurale të asaj date të ishin rezultat i dhunës fizike ose psikologjike.

44. Në përmbledhje, nga vendimi i gjykatës së shkallës së parë rezulton se për mënyrën sesi ajo ka trajtuar zbatimin e vendimeve të mëparshme të Gjykatës, ka mbajtur parasysht disa elemente. Së pari, gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006 nuk është përdorur si provë fajësie, pasi rezultatet e tij janë deklaruar të

papërdorshme. Së dyti, ajo ka arsyetuar se procesverbali i pyetjes së datës 30.10.2006 nuk është marrë si provë e drejtpërdrejtë për fajësinë, por është përdorur vetëm për kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit në gjykim, në kuptim të nenit 370, pika 1 të KPP-së. Së treti, gjykata ka shqyrtuar pretendimet për ushtrim dhune fizike ose psikologjike gjatë marrjes së deklarimeve dhe zhvillimit të veprimeve procedurale, por në përfundim ka çmuar se nuk rezultonte që kërkuesi të ishte detyruar me dhunë të jepte deklarime vetinkriminuese. Së fundi, gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se përfundimi për fajësinë e kërkuesit nuk mbështetet në një provë të vetme, por në tërësinë e provave dhe indicieve të administruara në gjykim.

45. Gjykata e apelit, në vijim, pas shqyrtimit të ankimit të kërkuesit, ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e saj ajo ka pranuar se veprat penale të vrasjes në rrethana të tjera cilësuese dhe të mbajtjes pa leje të armëve luftarake janë provuar në të njëjtat rrethana fakti të pranuar nga gjykata e shkallës së parë. Sipas saj, ngjarja është provuar nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe të analizuara në tërësinë e tyre, përfshirë aktet e fashikullit të gjykimit, deklaratimet e dëshmitarëve të bëra gjatë hetimeve paraprake dhe në gjykim, si dhe pohimet e kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake. Gjykata e apelit ka vlerësuar se provat janë çmuar në përputhje me nenet 149 dhe 152 të KPP-së, sipas bindjes së gjykatës, pas shqyrtimit të tyre në tërësi. Në këtë kuadër, gjykata e apelit ka arsyetuar se nga tërësia e provave provohej mekanizmi i ndodhjes së ngjarjes dhe autorësia e kërkuesit. Ajo ka evidentuar se aktet procedurale të mbajtura në vendngjarje, provat materiale të fiksuara aty, ekspertimet mjeko-ligjore, pohimet e kërkuesit në fazën e hetimeve paraprake dhe deklaratimet e dëshmitarëve bënë të mundur rindërtimin e mekanizmit të ngjarjes, duke identifikuar kërkuesin si personin që me veprimet aktive të kryera me armë zjarri u ka shkaktuar vdekjen viktimave. Gjykata e apelit ka marrë në analizë edhe prova të veçanta, ndër të tjera, këqyrjen e vendit të ngjarjes, gjurmën traseologjike, ekspertimin balistik, aktet mjeko-ligjore dhe deklaratimet e dëshmitarëve, për të mbështetur përfundimin se vendimi i shkallës së parë nuk mbështetet në një provë të vetme, por në tërësinë e provave dhe indicieve të administruara.

46. Në lidhje me pretendimet e kërkuesit për mosrespektimin e vendimeve nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës, gjykata e apelit ka rikujtuar fillimisht përfundimet e këtyre vendimeve për mënyrën e marrjes së procesverbalit të pyetjes së datës 30.10.2006 dhe të eksperimentit hetimor të së njëjtës datë. Për pretendimin për mungesën e mbrojtësit gjatë marrjes në pyetje, gjykata e apelit ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë, në zbatim të detyrave të lëna nga Gjykata, ka lejuar marrjen e dëshmisë së avokatit Q.B., i cili kishte nënshkruar procesverbalin si mbrojtës i kërkuesit gjatë pyetjes. Në këtë drejtim, gjykata e apelit ka marrë në konsideratë dëshminë e tij për kontaktin me kërkuesin, vijimin e procedurës së

pyetjes dhe nënshkrimin e procesverbalit, si dhe faktin se, sipas këtij dëshmitari, procesverbali është nënshkruar me vullnet të lirë nga kërkuesi.

47. Për sa i përket eksperimentit hetimor të datës 30.10.2006, gjykata e apelit ka vlerësuar se pretendimi për papërdorshmërinë e rezultateve të tij nuk kishte më bazë, për sa kohë ato nuk ishin përdorur nga gjykata e shkallës së parë në rigjykim. Ndërsa për pretendimet për ushtrim dhune, gjykata e apelit ka çmuar se ato janë hetuar në rigjykim dhe nuk kanë rezultuar të provuara. Në këtë drejtim, ajo ka mbajtur parasysh vendimin e pushimit të procedimit penal të regjistruar mbi pretendimet për dhunë, deklaratimet e avokatit Q.B. edhe në atë procedim, aktin e ekspertimit mjeko-ligjor nr. 269, datë 31.10.2006, si dhe rrethanat e tjera të administruara në gjykim.

48. Në përfundim, gjykata e apelit ka vlerësuar se në rigjykimin e çështjes gjykata e shkallës së parë ka përmbushur detyrat e lëna nga Gjykata në vendimet e saj nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016, si në drejtim të trajtimit të akteve të datës 30.10.2006, ashtu edhe në drejtim të shqyrtimit të pretendimeve për ushtrim dhune. Për rrjedhojë, ajo ka çmuar se pretendimet e kërkuesit për moszbatimin e këtyre vendimeve dhe për përdorimin e provave të marra në kundërshtim me garancitë kushtetuese janë të pabazuara.

49. Kërkuesi në vijim ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, duke kërkuar prishjen e vendimeve të dy gjykatave më të ulëta dhe pushimin e çështjes. Në rekurs ai ka pretenduar, ndër të tjera, se vendimet e gjykatave të faktit ishin në kundërshtim me vendimet nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës; se edhe në gjykimin e tretë fajësia e tij ishte lidhur përsëri me procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006; se gjykatat kishin shmangur vetëm formalisht, por jo në mënyrë substanciale përfundimet detyruese të Gjykatës; se procesverbali i datës 30.10.2006 ishte përdorur në dëm të tij pavarësisht se nuk ishte marrë formalisht si provë; se gjykatat nuk kishin dhënë përgjigje të mjaftueshme për provat dhe pretendimet që, sipas kërkuesit, mbështesnin pafajësinë e tij.

50. Çështja është shqyrtuar nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i cili ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së apelit, duke i vlerësuar si të pabazuara shkaqet e rekursit të kërkuesit. Sipas Kolegjit Penal, gjykatat e faktit, në rigjykim, kishin plotësuar mangësitë dhe parregullsitë e konstatuara nga Gjykata në vendimet nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016, duke i mbajtur parasysh këto vendime si detyrim kushtetues. Në këtë drejtim, ai ka vlerësuar të papranueshëm pretendimin se gjykatat e faktit i kishin dhënë vlerë të paracaktuar procesverbalit të pyetjes së datës 30.10.2006. Në lidhje me këtë procesverbal, Kolegji Penal ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë, me vendim të ndërmjetëm, nuk e kishte lejuar marrjen e tij si provë dhe se, madje, as prokurori nuk kishte kërkuar lejimin e tij si provë në kuadër të kërkesave për prova. Sipas Kolegjit Penal, vendimmarrja për deklarimin fajtor të kërkuesit nuk ishte bazuar në një

provë të vetme dhe aq më pak në procesverbalin e datës 30.10.2006, por në prova dhe indicie të rëndësishme, të sakta dhe të përputhura me njëra-tjetrën, të cilat, në unitet me provat e tjera shkencore dhe deklaratimet e dëshmitarëve, rindërtonin mekanizmin e ngjarjes.

51. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vënë në dukje se deklaratimet e datës 31.10.2006, të dhëna përpara prokurorit dhe në prani të mbrojtësit, ishin vlerësuar nga gjykatat e faktit në harmoni me provat e tjera dhe të shkëputura nga deklarimi i datës 30.10.2006. Sipas tij, gjykatat e faktit kanë marrë në analizë faktin se kërkuesi, në deklaratimet e datës 31.10.2006, ka pohuar se po tregonte ngjarjen “siç e kishte improvizuar” më parë, por njëkohësisht kanë evidentuar përshkrimet e detajuara prej tij për vendin e ngjarjes, pozicionin e viktimave dhe mekanizmin e kryerjes së veprës, pavarësisht se ai pretendonte se nuk kishte qenë i pranishëm në vendngjarje dhe familjarët nuk ishin lejuar të afroheshin nga Policia Gjyqësore. Kolegji Penal ka theksuar se ky fakt, i vetëm, nuk mund të ndikonte në fajësinë e kërkuesit, por ishte vlerësuar nga gjykatat në unitet me provat e tjera.

52. Për sa i përket eksperimentit hetimor të datës 30.10.2006, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vënë në dukje se gjykata e shkallës së parë ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruar prej tij, përfshirë procesverbalin e transkriptimit, pamjet filmike dhe fotografike, pasi ishin siguruar në shkelje të ligjit dhe duke cenuar të drejtën e mbrojtjes me avokat. Megjithatë, lidhur me këtë veprim hetimor dhe në funksion të verifikimit të pretendimit për dhunë, gjykata e shkallës së parë ka pyetur personat që kishin marrë pjesë në të dhe ka administruar transkriptimin e bisedave të zhvilluara gjatë kryerjes së eksperimentit. Sipas Kolegjit Penal, nga ky verifikim gjykatat e faktit kanë arritur në përfundimin se nuk kishte rezultuar përdorimi i dhunës ndaj kërkuesit gjatë këtyre veprimeve.

53. Në lidhje me pretendimin për dhunë fizike ose psikologjike, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se gjykatat e faktit kishin zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata për hetimin e dyshimeve për dhunë para dhe gjatë dhënies së deklaratimeve vetinkriminuese. Ai ka theksuar se gjykata e shkallës së parë ka kryer një hetim të mjaftueshëm për prejardhjen e dëmtimeve të konstatuara te kërkuesi dhe për rrethanat e marrjes së tij në pyetje, duke pyetur punonjësit e policisë të pranishëm në veprimet procedurale, si dhe avokatin Q.B. Sipas Kolegjit Penal, këta dëshmitarë kanë mohuar ushtrimin e dhunës ose presionit psikologjik ndaj kërkuesit, ndërsa shenjat e konstatuara nga ekspertimi mjeko-ligjor nuk provonin tej çdo dyshimi të arsyeshëm se dëmtimet ishin rezultat i dhunës së ushtruar nga oficerë të Policisë Gjyqësore gjatë marrjes së deklaratimeve.

54. Po ashtu, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka marrë në konsideratë se gjykata e shkallës së parë ka administruar edhe vendimin e pushimit të procedimit penal të datës 31.07.2009 të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të regjistruar pas

pretendimeve të kërkuarit për ushtrim dhune nga organet e policisë. Ai ka vënë në dukje edhe trajtimin nga gjykatat e faktit të akteve lidhur me ankesat e familjarëve të kërkuarit pranë Avokatit të Popullit. Në këtë drejtim, Kolegji Penal ka pranuar përfundimin e gjykatave të faktit se nga provat e administruara nuk rezultonte që vullneti i kërkuarit gjatë dhënies së deklarimeve të kishte qenë i vesuar për shkak të dhunës.

55. Më tej, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka ritheksuar se çmuarja e provave është kompetencë e gjykatave të faktit dhe se roli i saj, si gjykatë ligji, nuk është të zëvendësojë vlerësimin e tyre për faktet, përveç rasteve kur ka shkelje të ligjit ose cenim të garancive të procesit të rregullt. Në këtë kuadër, ajo ka vlerësuar se gjykata e apelit u ka dhënë përgjigje pretendimeve të kërkuarit dhe ka respektuar parimin e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit, duke i krijuar atij mundësinë për të paraqitur dhe verifikuar pretendimet e tij. Për pretendimet e tjera të ngritura në rekurs, Kolegji Penal ka çmuar se ato lidheshin kryesisht me vlerësimin e provave nga gjykatat e faktit. Ai ka evidentuar se gjykatat e faktit kanë analizuar pretendimet për mungesën e gjurmëve identifikuese të autorit, aktet e ekspertimit traseologjik, mungesën e motivit të pretenduar në raport me ekspertimin e ADN-së, pistën alternative lidhur me shtetasin A.M., si dhe pretendimet për kohën e saktë të vdekjes së viktimave. Sipas Kolegjit Penal, këto pretendime ishin shqyrtuar në detaje nga gjykatat e faktit, të cilat i kishin çmuar provat në tërësi, pa mbivlerësuar ndonjërin prej tyre.

56. Në përfundim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vlerësuar se vendimi i gjykatës së apelit nuk vinte në kundërshtim me vendimet nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës. Sipas tij, në rigjykimin e çështjes janë zbatuar detyrat e lëna nga Gjykata në lidhje me sqarimin e prejardhjes së dëmtimeve të konstatuara te kërkuari, kryerjen e një hetimi të plotë dhe të pavarur, si dhe provimin te çdo dyshimi të arsyeshëm të autorësisë së veprës. Për rrjedhojë, Kolegji Penal ka konkluduar se gjykatat e faktit kanë krijuar bindjen e brendshme të bazuar në prova për fajësinë e kërkuarit dhe se mekanizmi i ngjarjes është ai i përshkruar në procesverbalin e datës 31.10.2006.

Vlerësimi i pretendimeve të kërkuarit

57. Në vlerësimin e pakicës, pretendimet e kërkuarit do të duhej të ishin shqyrtuar në lidhje të ngushtë me njëra-tjetrën, pasi thelbi i tyre kushtetues nuk qëndron thjesht te mënyra e çmuarjes së provave nga gjykatat e zakonshme, por te verifikimi nëse, në gjykimin e tretë, ato kanë respektuar në mënyrë reale dhe efektive përfundimet detyruese të vendimeve nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës. Për këtë arsye, analiza në vijim përqendrohet, *së pari*, te pretendimi për cenimin e fuqisë detyruese të vendimeve të Gjykatës lidhur me përdorimin, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të deklarimeve të datës 30.10.2006 dhe të akteve të

lidhura me to, si dhe me ndikimin që ato kanë pasur realisht në arsyetimin e gjykatave të zakonshme për fajësinë e kërkuesit; *së dyti*, te pretendimi për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të së drejtës për të mos u vetinkriminuar; *së treti*, te standardi i arsyetimit të vendimeve gjyqësore, përfshirë kontrollin e ushtruar nga Gjykata e Lartë. Pretendimet për prezumimin e pafajësisë mbeten të vlerësohen në masën që lidhen me këto çështje kryesore dhe me ndikimin që përdorimi i akteve të kontestuara ka pasur në rregullsinë e procesit gjyqësor në tërësi.

58. Fillimisht, pakica vlerëson të evidentojë, sikurse edhe shumica në arsyetimin e saj, standardin kushtetues të zbatueshëm për fuqinë detyruese të vendimeve të Gjykatës. Sipas nenit 132 të Kushtetutës, vendimet e Gjykatës janë përfundimtare dhe kanë fuqi detyruese për të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike dhe gjykatat. Forca detyruese e vendimeve të Gjykatës shtrihet mbi të gjitha organet kushtetuese, autoritetet publike, duke përfshirë edhe gjykatat. Zbatimi i vendimeve të Gjykatës është detyrim kushtetues. Ato kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Si të tilla, përbëjnë jurisprudencë kushtetuese, për rrjedhojë kanë efektet e forcës së ligjit. Ky efekt detyrues ka të bëjë si me pjesën urdhëruese, ashtu edhe me pjesën arsyetuese të vendimit. Efekti detyrues shtrihet tek argumentet thelbësore të vendimit, që përbëjnë edhe *ratio decidendi*, eliminimi i të cilave do ta bënte vendimin, në tërësinë e tij, të pakuptimtë (*shih vendimet nr. 55, datë 10.07.2024; nr. 66, datë 06.12.2023; nr. 49, datë 03.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*). Po ashtu, standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor kërkon domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimit si një garanci për procesin e rregullt ligjor. Në tërësinë e tij vendimi duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës (*shih vendimet nr. 13, datë 21.03.2023; nr. 11, datë 24.05.2022; nr. 12, datë 19.03.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

59. Duke iu referuar këtij standardi në rrethanat e çështjes konkrete, në vlerësimin tonë, pretendimi i kërkuesit për cenimin e fuqisë detyruese të vendimeve nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës është i bazuar. Për të përcaktuar nëse këto vendime janë respektuar në procesin gjyqësor të kundërshtuar, duhet mbajtur parasysh, së pari, përmbajtja konkrete e përfundimeve detyruese të Gjykatës në vendimet e saj të mëparshme. Këto vendime mendojmë se nuk kanë pasur karakter thjesht orientues për gjykatat e zakonshme, por kanë përcaktuar kufij kushtetues të qartë për mënyrën sesi duhej të zhvillohej rigjykimi i çështjes së kërkuesit.

60. Kështu, në vendimin nr. 14/2011 Gjykata ka vlerësuar se gjykatat e zakonshme kishin përdorur si bazë të vendimmarrjes së tyre për fajësinë e kërkuesit procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006 dhe eksperimentin hetimor të së njëjtës datë. Gjykata ka konstatuar se mënyra e marrjes së këtyre akteve ishte e papajtueshme me garancitë kushtetuese të procesit të rregullt. Për procesverbalin e pyetjes, paligjshmëria lidhej, *së pari*, me faktin se deklarimet

vetinkriminuese ishin marrë pa praninë efektive dhe të detyrueshme të mbrojtësit, ndërkohë që avokati Q.B., në dëshminë e dhënë në gjykimin fillestar, kishte deklaruar se kur kishte mbërritur në ambientet e policisë pyetja e kërkuesit kishte përfunduar dhe ai kishte nënshkruar më pas procesverbalin, pasi kishte pyetur kërkuesin nëse e kishte firmosur atë dhe nëse e kishte kryer krimin, duke marrë prej tij përgjigje pohuese. *Së dyti*, Gjykata ka mbajtur parasysh ekzistencën e dyshimeve serioze se deklarimet vetinkriminuese ishin marrë nën dhunë, për sa kohë akti mjeko-ligjor kishte konstatuar dëmtime trupore të kërkuesit, ndërsa autoritetet nuk kishin kryer veprimet e nevojshme për sqarimin e plotë të origjinës së tyre. Për eksperimentin hetimor, Gjykata ka vlerësuar se ai ishte kryer menjëherë pas vetinkrimimit të kërkuesit, në rrethana që krijojnë dyshime serioze për ligjshmërinë e tij dhe, për më tepër, pa praninë e mbrojtësit dhe të prokurorit.

61. Në vijim, në vendimin nr. 20/2016 Gjykata ka konstatuar se gjykatat e zakonshme nuk kishin respektuar përfundimet e vendimit nr. 14/2011 dhe nuk kishin riparuar shkeljet e konstatuara. Edhe në atë proces gjyqësor, sipas Gjykatës, gjykatat e zakonshme kishin përdorur si bazë për vendimmarrjen për fajësinë e kërkuesit procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006 dhe eksperimentin hetimor të së njëjtës datë. Për procesverbalin e pyetjes, Gjykata ka vlerësuar se ndonëse ai ishte përjashtuar formalisht nga provat e lejuara në gjykim, ishte përdorur më pas për kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit në gjykim. Për shkak të mënyrës së marrjes së tij, Gjykata e ka konsideruar këtë akt absolutisht të pavlefshëm, në kuptim të nenit 128, pika 1, shkronja “c”, të KPP-së dhe ka theksuar se ai nuk mund të përdorej nga prokuroria për të kundërshtuar, tërësisht ose pjesërisht, deklarimet e kërkuesit në gjykim. Sipas Gjykatës, deklarimet e bëra nga kërkuesi, duke inkriminuar veten pa praninë e mbrojtësit, nuk mund të shfrytëzoheshin kundër tij dhe, për rrjedhojë, nuk mund të përdreshin as për efekt kundërshtimi ose besueshmërie. Për eksperimentin hetimor, Gjykata ka konstatuar se ai ishte përdorur si provë kryesore për të konkluduar për fajësinë e kërkuesit, megjithëse në vendimin nr. 14/2011 ishte shprehur për paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së tij.

62. Nga këto përfundime, në vlerësimin tonë, rezulton qartë se Gjykata nuk u ka lënë gjykatave të zakonshme, në gjykimin e tretë të çështjes, detyrën për të hetuar për ligjshmërinë e mënyrës së marrjes së procesverbalit të pyetjes së datës 30.10.2006 dhe të eksperimentit hetimor të së njëjtës datë dhe, në varësi të këtij rivlerësimi, të vendosnin për përdorshmërinë e tyre në proces. Përkundrazi, Gjykata i kishte konsideruar këto akte si të marra në mënyrë të paligjshme dhe kishte përcaktuar kufirin kushtetues të përdorimit të tyre, pra se ato nuk mund të përdreshin kundër kërkuesit, as drejtpërdrejt si prova fajësie, as në mënyrë të tërthortë, kur përmbajtja ose pasojat e tyre ndikojnë konkretisht në kundërshtimin e deklarimeve, në vlerësimin e besueshmërisë ose në ndërtimin e arsyetimit për fajësinë. Pra, kufiri kushtetues

nuk lidhej vetëm me praninë formale të këtyre akteve në fashikullin e provave, por edhe me ndalimin që përmbajtja ose pasojat e tyre të ndikonin realisht në arsyetimin për fajësinë. Në vlerësimin tonë, hetimi i mëvonshëm i pretendimeve për dhunë nuk mund të shërbente për të rivlerësuar përdorshmërinë e procesverbalit të datës 30.10.2006, por vetëm për të sqaruar rrethanat e pretenduara të keqtrajtimit dhe për të përmbushur detyrimet pozitive të shtetit që rrjedhin nga nevoja për hetim efektiv të këtyre pretendimeve. Për këtë arsye, pretendimet për dhunë marrin rëndësi në këtë analizë jo si bazë për të rivlerësuar ligjshmërinë ose përdorshmërinë e akteve të datës 30.10.2006, por për të vlerësuar nëse mënyra sesi gjykatat e zakonshme i trajtuan ato ka lejuar që përmbajtja ose pasojat e akteve të kontestuara të vijonin të ndikonin realisht në arsyetimin për fajësinë.

63. Në këtë pikë qëndron edhe dallimi i qasjes së pakicës. Edhe nëse pranohet se, në procesin gjyqësor të kundërshtuar, gjykatat e zakonshme kanë administruar ose riadministruar prova për të sqaruar rrethanat e marrjes së deklarimeve dhe pretendimet për ushtrim dhune, ky hetim nuk mund të ndryshonte kufirin kushtetues të vendosur më parë nga Gjykata. Ai nuk mund të shërbente për ta trajtuar procesverbalin e datës 30.10.2006 si akt të përdorshëm për kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit në gjykim, as për të rivlerësuar nëse deklaratimet vetinkriminuese ishin marrë në mënyrë të ligjshme. Në vendimin nr. 20/2016 Gjykata nuk është kufizuar vetëm në konstatimin se procesverbali i datës 30.10.2006 nuk duhej të merrej formalisht si provë, por ka sqaruar se përdorimi i një akti procedural absolutisht të pavlefshëm për të përcaktuar besueshmërinë e të pandehurit do ta bënte të pavlefshëm edhe vetë vlerësimin e besueshmërisë. Për rrjedhojë, kufiri kushtetues i vendosur prej saj nuk ishte vetëm ndalimi i përdorimit formal të procesverbalit si provë fajësie, por ndalimi i çdo përdorimi të tij në dëm të kërkuesit, përfshirë përdorimin për të kundërshtuar versionin e tij mbrojtës ose për të vënë në dyshim besueshmërinë e mohimit të akuzës.

64. Në procesin gjyqësor të kundërshtuar, gjykata e shkallës së parë ka deklaruar të papërdorshme provat e siguruara nga eksperimenti hetimor i datës 30.10.2006. Megjithatë, pavarësisht këtij përjashtimi formal, gjykatat e zakonshme i janë referuar përmbajtjes ose pasojave të atij veprimi në një mënyrë që ka ndikuar konkretisht në arsyetimin për fajësinë, duke u mbështetur në dëshmitë e punonjësve të policisë që morën pjesë në të, në transkriptimin e bisedave të zhvilluara gjatë tij dhe në përputhjen e përshkrimit të kërkuesit me të dhënat e vendngjarjes. Kjo mënyrë arsyetimi nuk tregon se përfundimi për fajësinë është ndërtuar në mënyrë të pavarur nga akti i përjashtuar, për sa kohë eksperimenti hetimor ishte zhvilluar menjëherë pas deklarimeve vetinkriminuese të datës 30.10.2006 dhe ishte pjesë e të njëjtit zinxhir procedural të kontestuar. Për rrjedhojë, edhe pse eksperimenti hetimor nuk figuron

formalisht si provë fajësie, mbetet problemi nëse informacioni i prodhuar prej tij ka ndikuar realisht në arsyetimin për fajësinë e kërkuesit.

65. E njëjta gjë vlen edhe për procesverbalin e pyetjes së datës 30.10.2006. Gjykatat e zakonshme e kanë pranuar përdorimin e tij me arsyetimin se ai nuk është lejuar si provë fajësie, por vetëm për kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit dhe për vlerësimin e besueshmërisë së tij. Mirëpo, pikërisht këtë mënyrë përdorimi Gjykata e ka ndaluar shprehimisht në vendimin nr. 20/2016. Për më tepër, në gjykimin e tretë, gjykatat e zakonshme kanë rivlerësuar rrethanat e marrjes së deklarimeve të datës 30.10.2006, duke arritur në përfundimin se avokati Q.B. ka qenë i pranishëm gjatë pyetjes dhe se nuk provohej ushtrimi i dhunës ndaj kërkuesit. Në vlerësimin tonë, një qasje e tillë bie ndesh me përfundimet detyruese të vendimeve nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016, në të cilat Gjykata kishte konstatuar paligjshmërinë e mënyrës së marrjes së deklarimeve të kërkuesit sipas këtij procesverbali. Hetimi i pretendimeve për dhunë mund të kishte rëndësi për sqarimin e përgjegjësive të mundshme të organeve shtetërore dhe për vlerësimin e drejtësisë së procesit në tërësi, por nuk mund të shërbente për ta bërë të përdorshëm një akt që Gjykata e kishte konsideruar më parë absolutisht të pavlefshëm dhe të papërdorshëm kundër kërkuesit.

66. Dallimi formal ndërmjet “përdorimit si provë fajësie” dhe “përdorimit për kundërshtim” nuk është i mjaftueshëm për të shmangur shkeljen kushtetuese. Në një proces penal, kur deklaratimet e mëparshme të të pandehurit përdoren për të kundërshtuar qëndrimin e tij në gjykim dhe për të vënë në dyshim besueshmërinë e versionit të tij mbrojtës, ato mund të ndikojnë realisht në arsyetimin për fajësinë. Kjo qasje përputhet edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas së cilës privilegji kundër vetinkriminimit nuk kufizohet vetëm te deklaratimet drejtpërdrejt inkriminuese, por përfshin edhe deklaratime që në dukje janë shfajësuese ose japin informacion faktik, kur ato përdoren më pas për të kundërshtuar deklaratime të tjera të të akuzuarit, për të vënë në dyshim provat e dhëna prej tij gjatë gjyimit ose për të cenuar në një mënyrë tjetër besueshmërinë e tij (*shih Ibrahim dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar [DHM], viti 2016, §268*). Për rrjedhojë, edhe nëse procesverbali i datës 30.10.2006 nuk është përfshirë formalisht në listën e provave të fajësisë, përdorimi i tij kundër kërkuesit, në një mënyrë që ka ndikuar konkretisht në arsyetimin për fajësinë, përbën përdorim të të njëjtit akt të përjashtuar më parë nga standardi kushtetues. Për këtë arsye, pas vendimit të Gjykatës nr. 20/2016, gjykatat e zakonshme nuk mund të përsërisnin të njëjtën qasje të konstatuar më parë si të papajtueshme me Kushtetutën, duke e mbështetur përsëri përdorimin e atij akti te neni 370, pika 1 i KPP-së.

67. Mendojmë se edhe referimi i gjykatave të zakonshme te deklaratimet e kërkuesit të datës 31.10.2006 nuk e zgjidh këtë problem. Është e vërtetë se këto deklaratime janë dhënë

përpara prokurorit dhe në prani të mbrojtësit. Megjithatë, në atë moment kërkuesi ka mohuar autorësinë e vrasjes dhe ka pretenduar se pohimet e mëparshme ishin bërë nën presionin dhe dhunën e policisë, duke shpjeguar se ka riprodhuar një version të improvizuar. Për këtë arsye, gjykatat kanë pasur detyrimin të shpjegojnë në mënyrë bindëse pse deklaratimet e datës 31.10.2006 mund të konsideroheshin të pavarura nga aktet e datës 30.10.2006 dhe jo vazhdimësi e të njëjtit zinxhir procedural të kontestuar. Ky arsyetim në vlerësimin tonë mungon. Gjykatat e zakonshme kanë theksuar se deklaratimet e datës 31.10.2006 përputheshin me të dhënat objektive të vendngjarjes dhe se një përshkrim i tillë nuk mund të ishte produkt i fantazisë ose improvizimit. Megjithatë, ky arsyetim nuk i përgjigjet çështjes kushtetuese vendimtare, pra nëse përshkrimi i datës 31.10.2006 ka qenë vërtet burim i pavarur prove apo përsëritje e një versioni të marrë fillimisht në datën 30.10.2006, në rrethana të konsideruara më parë problematike nga Gjykata për shkak të mungesës së mbrojtësit, dyshimeve për dhunë dhe vetinkriminimit.

68. Për më tepër, përputhja e disa detajeve të deklaratimeve të datës 31.10.2006 me të dhënat objektive të vendngjarjes nuk mjafton, në vetvete, për të provuar se këto deklarime përbënin burim të pavarur prove, të shkëputur nga aktet e datës 30.10.2006. Gjykatat e zakonshme kanë arsyetuar se detajet e dhëna nga kërkuesi për hyrjen në banesë, goditjen e derës me këmbë, pozicionin e viktimave, mënyrën dhe drejtimin e qitjes, si dhe mënyrën sesi kishin rënë viktimat, nuk mund të shpjegoheshin si produkt i fantazisë ose i improvizimit. Megjithatë, ky arsyetim nuk merr mjaftueshëm në konsideratë rrethanat konkrete të çështjes, veçanërisht faktin se kërkuesi ka qenë i lirë për gati 9 muaj pas ngjarjes, ka qenë i pranishëm pranë vendit të ngjarjes gjatë kohës kur janë kryer veprimet e para hetimore, ka pasur lidhje të afërt familjare me viktimat dhe ka vijuar të banojë me familjarët e tij në një banesë pranë asaj të viktimave. **Po ashtu**, ngjarja ka pasur jehonë në opinionin publik dhe, pas ndodhjes së saj, është bërë objekt i një raportimi të gjerë mediatik. Në këto kushte, nuk mund të përjashtohet apriori mundësia që, gjatë kësaj periudhe, ai të kishte marrë dijeni nga burime të tjera për rrethanat e caktuara të ngjarjes dhe të vendngjarjes. Për këtë arsye, gjykatat e zakonshme duhej të shpjegojnë pse njohja e këtyre rrethanave nga kërkuesi duhej të konsiderohej domosdoshmërisht si tregues i autorësisë ose i besueshmërisë së deklaratimeve të kontestuara, dhe jo si njohuri e fituar nga burime të tjera ose si përsëritje e një versioni të marrë më parë në rrethanat e kontestuara të datës 30.10.2006.

69. Në këtë aspekt, pretendimi i kërkuesit për cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe të së drejtës për të mos u vetinkriminuar është gjithashtu i bazuar. Prania e mbrojtësit në fazat fillestare të procedimit penal nuk është garanci formale, por garanci efektive për të mbrojtur personin nga presioni, keqtrajtimi dhe vetinkriminimi i pavullnetshëm. Këtë standard e ka

pranuar Gjykata në vendimin nr. 14/2011, kur ka theksuar se mbrojtësi duhet të jetë i pranishëm gjatë marrjes në pyetje dhe duhet të kujdeset realisht për interesat e personit që pyetet. Në të njëjtën linjë, GJEDNJ-ja ka theksuar se, në mënyrë që e drejta për një gjykim të drejtë të mbetet mjaftueshëm “praktike dhe efektive”, neni 6 § 1 i Konventës kërkon që, si rregull, aksesi te një avokat duhet të sigurohet që nga marrja e parë në pyetje e një të dyshuari nga policia, përveçse nëse demonstron në dritën e rrethanave të veçanta të secilit rast se ka arsye bindëse për të kufizuar këtë të drejtë. Edhe kur arsyet bindëse mund të justifikojnë në mënyrë përjashtimore mohimin e aksesit te një avokat, një kufizim i tillë - cilido qoftë justifikimi i tij - nuk duhet të cenohet padrejtësisht të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 6. Të drejtat e mbrojtjes do të cenohen, në parim, në mënyrë të pariparueshme kur deklarime vetinkriminuese të bëra gjatë marrjes në pyetje nga policia pa akses te një avokat përdoren për një dënim (*shih Salduz kundër Turqisë [DHM], viti 2008, §55*).

70. GJEDNJ-ja ka theksuar gjithashtu se e drejta e aksesit te avokati nuk kufizohet vetëm te prania fizike e tij gjatë marrjes në pyetje. Sipas saj, i dyshuari duhet të jetë në gjendje të hyjë në kontakt me avokatin që nga momenti i marrjes në paraburgim dhe të këshillohet me të përpara marrjes në pyetje. Ky konsultim duhet të jetë privat dhe t’i mundësojë avokatit të marrë udhëzime konfidenciale nga klienti. Po ashtu, i dyshuari ka të drejtë që avokati të jetë fizikisht i pranishëm gjatë marrjes së parë në pyetje nga policia dhe sa herë që ai pyetet në procedurat pasuese paraprahe. Kjo prani fizike duhet t’i mundësojë avokatit të japë ndihmë praktike dhe efektive, jo thjesht abstrakte, dhe në veçanti për të siguruar që të drejtat e mbrojtjes së personit që merret në pyetje të mos cenohen (*shih Beuze kundër Belgjikës [DHM], viti 2018, §§133-134*). Po sipas GJEDNJ-së, kur nuk ka arsye bindëse për kufizimin e aksesit në ndihmë juridike, vlerësimi i drejtësisë së procesit duhet t’i nënshtrohet një kontrolli shumë të rreptë. Në një rast të tillë barra i takon shtetit të tregojë në mënyrë bindëse se, përjashtimisht dhe në rrethanat konkrete të çështjes, drejtësia e procesit në tërësi nuk është cenuar në mënyrë të pariparueshme nga ky kufizim. Në vlerësimin e procesit në tërësi, rëndësi merr, ndër të tjera, nëse kërkuesi ka pasur mundësi të kundërshtojë vërtetësinë e provës dhe t’i kundërvihet përdorimit të saj; cilësia e provës dhe nëse rrethanat në të cilat ajo është marrë krijojnë dyshime për besueshmërinë ose saktësinë e saj; paligjshmëria e marrjes së provës dhe natyra e shkeljes përkatëse; në rastin e deklarimeve, natyra e tyre dhe nëse ato janë tërhequr ose ndryshuar menjëherë; përdorimi që i është bërë provës, veçanërisht nëse ajo ka përbërë pjesë integrale ose të rëndësishme të materialit provues mbi të cilin është mbështetur dënimi, duke pasur parasysh edhe forcën e provave të tjera në çështje (*po aty, §§145 dhe 150*). Këta faktorë, të zbatuar në rastin konkret, nuk u jepnin gjykatave të zakonshme hapësirë për të rivlerësuar përdorshmërinë e akteve të datës 30.10.2006, pasi për këtë çështje Gjykata ishte shprehur

tashmë në mënyrë detyruese. Megjithatë, ato kërkonin që gjykatat të vlerësonin nëse përmbajtja ose pasojat e këtyre akteve kishin vijuar të ndikonin realisht në arsyetimin për fajësinë e kërkuarit, duke marrë parasysh cilësinë dhe besueshmërinë e deklarimeve të kontestuara, rrethanat në të cilat ato ishin marrë, kundërshtimin e tyre nga kërkuari, si dhe përdorimin që u ishte bërë në arsyetimin gjyqësor.

71. Në rastin konkret mendojmë se merr rëndësi të veçantë ndalimi i vetinkriminimit. Neni 32 i Kushtetutës ndalon detyrimin e personit për të dëshmuar kundër vetes ose për të pranuar fajësinë, si dhe deklarinin fajtor mbi bazën e të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme. Në vendimin nr. 14/2011 Gjykata ka lidhur drejtpërdrejt mungesën e mbrojtësit, pretendimet për dhunë dhe përdorimin e deklarimeve vetinkriminuese me cenimin e procesit të rregullt. Në këtë kuptim, gjykatat e zakonshme nuk mund ta rikthenin aktin e datës 30.10.2006 në funksion të arsyetimit për fajësinë, duke rivlerësuar të njëjtat rrethana sikur mbi këtë akt të mos ishte shprehur më parë Gjykata. Në vlerësimin tonë, gjykatat e zakonshme në procesin gjyqësor të kundërshtuar nuk e kanë trajtuar vendimin e Gjykatës nr. 20/2016 si kufi detyrues kushtetues, por si një pengesë formale që mund të shmangej përmes ndryshimit të mënyrës së emërtimit të përdorimit të aktit. Ndërkohë, standardi i vendosur nga Gjykata ka qenë i qartë, pra se procesverbali i datës 30.10.2006 nuk mund të përdorej kundër kërkuarit as për kundërshtim, as për besueshmëri, sepse një përdorim i tillë do të ndikonte përsëri në vlerësimin e versionit të tij mbrojtës dhe, për rrjedhojë, në përfundimin për fajësinë e tij.

72. Kjo qasje bie ndesh edhe me logjikën e jurisprudencës së GJEDNJ-së për provat e kontestuara për shkak të mënyrës së marrjes së tyre. GJEDNJ-ja ka theksuar se përdorimi në procedimin penal i deklarimeve të marra si rezultat i torturës ose i formave të tjera të keqtrajtimit në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së e bën procesin në tërësi të padrejtë, pavarësisht nga vlera provuese e deklarimeve dhe pavarësisht nëse përdorimi i tyre ka qenë vendimtar për dënimin. Edhe kur bëhet fjalë për prova të marra në shkelje të të drejtave të tjera, drejtësia e procesit duhet të vlerësohet duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e çështjes, përfshirë respektimin e të drejtave të mbrojtjes, si dhe cilësinë dhe rëndësinë e provës së kontestuar (*shih Gäfgen kundër Gjermanisë [DHM], viti 2010, §§165-166*).

73. Në të njëjtën linjë, në çështjen Jannatov kundër Azerbajxhanit, GJEDNJ-ja ka mbajtur parasysh se gjykatat vendase ishin mbështetur në deklarinin e kërkuarit të bërë gjatë hetimit, me të cilin ai kishte pranuar përfshirjen në krim. Megjithatë GJEDNJ-ja nuk konstatoi shkelje materiale të nenit 3 të KEDNJ-së, ajo vuri në dukje se autoritetet vendase kishin dështuar të zhvillonin një hetim efektiv mbi pretendimet për keqtrajtim. Për këtë arsye, rrethanat në të cilat ishte marrë deklarimi krijojnë dyshime për besueshmërinë dhe saktësinë e tij. GJEDNJ-ja vlerësoi se gjykatat vendase nuk mund të mjaftoheshin me përfundimet e

autoriteteve hetimore që kishin refuzuar nisjen e procedimit penal, por duhej të kryenin vetë një shqyrtim të pavarur dhe të plotë të pretendimeve për mënyrën e marrjes së deklarimeve, si dhe të vlerësonin në mënyrë të mjaftueshme nëse këto rrethana cenonin drejtësinë e procesit (*shih Jannatov kundër Azerbajxhanit, viti 2014, §§74-76*). Edhe në çështjen në shqyrtim, për shkak se deklaratimet e datës 30.10.2006 ishin kundërshtuar si të marra nën dhunë dhe ishin të lidhura me aktet që shërbyen si bazë fillestare për ndërtimin e akuzës, gjykatat nuk mund të mjaftoheshin me vendimin e pushimit të procedimit penal ose me mohimet e punonjësve të policisë, por duhej të jepnin vetë një përgjigje të pavarur, të plotë dhe bindëse për rrethanat faktike në të cilat kërkuesit i janë shkaktuar dëmtimet e konstatuara.

74. Për këto arsye, mendojmë se është i bazuar edhe pretendimi i kërkuesit se gjykatat e zakonshme nuk u kanë dhënë përgjigje të mjaftueshme pretendimeve të tij për dhunë dhe keqtrajtim. Ky pretendim shqyrtohet në funksion të tezës kryesore të pakicës. Ai nuk lidhet me mundësinë e gjykatave të zakonshme për të rivlerësuar përdorshmërinë e procesverbalit të datës 30.10.2006 ose të eksperimentit hetimor, pasi për këtë Gjykata ishte shprehur tashmë në mënyrë detyruese. Ai lidhet, përkundrazi, me vlerësimin nëse mënyra sesi gjykatat e zakonshme i trajtuan pretendimet për dhunë ka shërbyer për të konsideruar të kapërcyer problemin kushtetues të akteve të datës 30.10.2006 dhe për të lejuar që përmbajtja ose pasojat e tyre të vijonin të ndikonin realisht në arsyetimin për fajësinë. Në vendimin nr. 14/2011 Gjykata nuk ka konstatuar thjesht ekzistencën e një pretendimi abstrakt për dhunë, por ka evidentuar dëmtimet e konstatuara në trupin e kërkuesit dhe nevojën për sqarimin e plotë të origjinës së tyre. Ajo ka theksuar se kur organi procedues vihet në kontakt me pretendime dhe dyshime serioze për ushtrim dhune, ai duhet të ndërmarrë veprime të mëtejshme për të sqaruar prejardhjen e dëmtimeve dhe rrethanat në të cilat personi është marrë në pyetje. Në lidhje me këtë, në procesin gjyqësor të kundërshtuar, gjykatat e zakonshme kanë administruar disa prova, përfshirë dëshmitë e punonjësve të policisë, dëshminë e avokatit Q.B., aktin mjeko-ligjor dhe vendimin e pushimit të procedimit penal për pretendimet për dhunë. Megjithatë, ato nuk kanë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme përse këto prova ishin të afta të përjashtonin dyshimet serioze të evidentuara më parë nga Gjykata dhe përse dëmtimet e konstatuara nuk kishin lidhje me rrethanat e marrjes së deklarimeve vetinkriminuese. Mendojmë se referimi të mohimet e punonjësve të policisë dhe të vendimi i pushimit të procedimit penal nuk mjafton, veçanërisht kur vetë Gjykata kishte vënë në dyshim më parë mjaftueshmërinë e sqarimit të këtyre rrethanave.

75. Në veçanti, mendojmë se gjykatat e zakonshme nuk kanë arsyetuar në mënyrë të plotë sesi duhej të vlerësohej fakti që kërkuesi ka pretenduar dhunë menjëherë pas deklarimeve vetinkriminuese, se akti mjeko-ligjor ka konstatuar dëmtime në trupin e tij dhe se këto

pretendime lidheshin drejtpërdrejt me aktet që kishin shërbyer si bazë fillestare për ndërtimin e akuzës. Kjo mungesë arsyetimi merr rëndësi sepse trajtimi i pretendimeve për dhunë është përdorur nga gjykatat e zakonshme si një nga arsyet për të konsideruar se deklaratimet e datës 30.10.2006, deklaratimet e mëvonshme dhe veprimet e lidhura me to nuk ishin rezultat i presionit ose keqtrajtit. Në këtë mënyrë, analiza e pamjaftueshme e këtyre pretendimeve ka ndikuar në mënyrën sesi gjykatat e zakonshme e kanë konsideruar të kapërcyer problemin kushtetues të akteve të kontestuara dhe pasojave të tyre në proces. Edhe sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, kur personi pretendon se është keqtrajtuar nga policia dhe dëmtimet e tij konstatohen nga mjeku në një kontekst që lidhet me mbajtjen nën kontroll policor, aktivizohet detyrimi procedural i shtetit për të hetuar pretendimet. Nëse kërkuesi paraqet elemente të mjaftueshme për të krijuar një prezumim të fortë se dëmtimet janë pësuar në paraburgim policor, barra kalon te shteti për të dhënë një shpjegim të kënaqshëm dhe bindës për origjinën e tyre, duke paraqitur prova që vënë në dyshim versionin e ngjarjeve të dhënë nga personi që pretendon keqtrajtimin (*shih Babić kundër Kroacisë, viti 2023, §§21, 32-33*). Në këtë kontekst, në një proces penal ku dënimi është me burgim të përjetshëm, mendojmë se ky detyrim për arsyetim dhe verifikim merr rëndësi të veçantë.

76. Edhe pretendimi i kërkuesit për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor, në vlerësimin tonë, është i bazuar. Është e vërtetë se gjykatat e zakonshme nuk kanë detyrimin të pranojnë çdo argument të mbrojtjes, por ato duhet t'u japin përgjigje pretendimeve thelbësore, që në rastin konkret lidheshin me përdorimin e akteve të kontestuara, me zbatimin e vendimeve të Gjykatës dhe me ekzistencën e një baze provuese të pavarur nga deklaratimet e datës 30.10.2006. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka pranuar se detyrimi për garantimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor nuk nënkupton se kërkohet përgjigje e detajuar për çdo pretendim të palëve. Ai ndryshon në varësi të rrethanave të çështjes konkrete dhe natyrës së vendimit (*shih vendimet nr. 21, datë 26.09.2022; nr. 6, datë 16.02.2021; nr. 79, datë 14.12.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

77. Në këtë drejtim, mangësia e arsyetimit nuk lidhet vetëm me vendimin e Gjykatës së Lartë, por me mënyrën sesi gjykatat e zakonshme, në tërësi, kanë trajtuar pretendimet thelbësore të kërkuesit. Gjykatat e faktit kanë pranuar se procesverbali i datës 30.10.2006 nuk është përdorur si provë fajësie dhe se eksperimenti hetimor është përjashtuar formalisht nga provat, por ato nuk kanë shpjeguar në mënyrë të mjaftueshme nëse përmbajtja ose pasojat e këtyre akteve kanë vijuar të ndikojnë realisht në arsyetimin për fajësinë. Po ashtu, ato nuk kanë dhënë përgjigje të plotë për pavarësinë e deklaratimeve të datës 31.10.2006 nga aktet e kontestuara të një dite më parë, as për arsyen pse njohja e disa detajeve të vendngjarjes nga

kërkuesi duhej të konsiderohej domosdoshmërisht tregues i autorësisë dhe jo njohuri e marrë nga burime të tjera ose përsëritje e një versioni të mëparshëm të kontestuar.

78. Nga ana e saj, edhe Gjykata e Lartë nuk i ka dhënë përgjigje thelbit të këtyre pretendimeve. Ajo ka vlerësuar se gjykatat e faktit nuk e kanë mbështetur vendimmarrjen e tyre në procesverbalin e datës 30.10.2006 dhe në eksperimentin hetimor, por në prova të tjera të administruara në gjykim. Megjithatë, çështja nuk lidhet vetëm me faktin nëse aktet e datës 30.10.2006 figuronin formalisht si prova në vendim, por nëse ato kanë vijuar të ndikonin realisht në arsyetimin për fajësinë, përmes vlerësimit të besueshmërisë së kërkuesit, rindërtimit të dinamikës së ngjarjes dhe përfundimit për autorësinë e tij. Gjykata e Lartë, po ashtu, nuk ka sqaruar as përse përdorimi i procesverbalit të datës 30.10.2006 për kundërshtimin e deklarimeve të kërkuesit pajtohej me vendimin nr. 20/2016, me të cilin Gjykata e kishte ndaluar shprehimisht këtë përdorim. Gjithashtu, ajo nuk ka analizuar nëse deklaratimet e datës 31.10.2006 ishin realisht të pavarura nga aktet e kontestuar të një dite më parë, apo nëse ato përbënin vazhdimësi të të njëjtit proces procedural të dëmtuar. Këto pretendime kanë natyrë kushtetuese dhe rëndësi vendimtare për rezultatin e çështjes, ndaj kërkohet përgjigje të qartë dhe të posaçme.

79. Në këtë kuptim, mendojmë se në rastin konkret nuk jemi përpara një kërkesë për rivlerësim të zakonshëm të provave, gjë që nuk i takon juridiksionit kushtetues. Përkundrazi, jemi përpara një pretendimi se gjykatat e zakonshme kanë përdorur akte procedurale të cilat Gjykata i ka konsideruar më parë të papërdorshme në dëm të kërkuesit, në një mënyrë që ka ndikuar realisht në arsyetimin për fajësinë e tij. Ky pretendim nuk lidhet me bindjen e brendshme të gjykatave për faktet, por me ligjshmërinë kushtetuese të burimit dhe përdorimit të provave që kanë ndikuar realisht në këtë arsyetim.

80. Për sa u përket pretendimeve të kërkuesit për prezumimin e pafajësisë, nuk është i nevojshëm shqyrtimi i tyre në mënyrë tërësisht të pavarur nga pretendimet e mësipërme. Ato marrin rëndësi në masën që lidhen me përdorimin e akteve të kontestuar dhe me mënyrën sesi gjykatat kanë ndërtuar bindjen për fajësinë e kërkuesit. Në vlerësimin e pakicës, kur deklaratime vetinkriminuese të marra në rrethana të kontestuar dhe të përjashtuara nga standardi kushtetues vijojnë të ndikojnë realisht në arsyetimin për fajësinë, cenohet edhe garancia që fajësia të provohet nga akuza mbi baza të ligjshme dhe përtej çdo dyshimi të arsyeshëm.

81. Në përfundim, në vlerësimin tonë, pretendimet e kërkuesit për cenimin e procesit të rregullt ligjor janë të bazuara në aspektet që lidhen me moszbatimin e vendimeve nr. 14/2011 dhe nr. 20/2016 të Gjykatës, me përdorimin e deklaratimeve të datës 30.10.2006 dhe të akteve të lidhura me to, për sa kohë ato kanë ndikuar realisht në arsyetimin për fajësinë e kërkuesit, me cenimin e së drejtës së mbrojtjes dhe së drejtës për të mos u vetinkriminuar, si dhe me

standardin e arsytimit të vendimeve gjyqësore. Këto shkelje kanë ndikuar në rregullsinë e procesit në tërësi dhe nuk mund të konsiderohen të riparuar nga arsytimi i gjykatave të zakonshme. Për këtë arsye, mbajtëm qëndrimin se kërkesa duhej pranuar në tërësi, duke u shfuqizuar të tria vendimet gjyqësore të kundërshtuara dhe duke u dërguar çështja për shqyrtim në gjykatën kompetente të shkallës së parë. Në vlerësimin tonë, vetëm shfuqizimi i vendimit të Gjykatës së Lartë nuk do të ishte mjet i mjaftueshëm për rivendosjen e së drejtës së cenuar kërkuarit, pasi shkeljet lidhen me mënyrën sesi gjykatat e faktit kanë zhvilluar gjykimin dhe kanë ndërtuar arsytimin për fajësinë e tij.

Anëtarë: Genti Ibrahimi, Ilir Toska